

Xhafer Durmishi
SKENDER

VEPRA

9



LUGA DHE LUGINA

PARAFJALË

1. Ibrahim Kelmendi - Vetëtima e Luginës së Preshevës
2. DO TA DISKREDITOJA EDHE PËR SË VDEKURI PËR TË PABESË E INTRIGANT
3. Ç'do të thotë fjala vojvodë?
4. ***ATY KA QENË EDHE LUGA E VOJVODËS***
-Kush është vojvoda Ramë Nikçi?
5. Prej gjyshit Ibush deri te djali i Dajës Ramadan
6. PORTRETE FEMRASH - Në librin *Atentatet* të Ibrahim Kelmendit dhe diskutimet rreth tij

I KURVA, KURVARË DHE KURVËRIME

- 1. Shqiptarët kurvarë garonin midis tyre
- 2. Faturat përmbajnë tatimin e vlerës së shtuar
- 3. A të fascinoi edhe për bixhoz dhe kurvëri
- 4. U tërbova duke i thënë kurvar
- 5. Sa për kurvërim të kam ty këtu më afër
- 6. Kapni kurvarët që jua bënë shoshë gratë e vajzat

- 7. Nuk ka bir nëne e as bir kurve
- 8. Shkrimtari harton fabula
- 9. Qenke njeri i poshtër
- 10. Pa pretendim për të qenë të vërteta historike
- 11. Mos më keqkuptoni, por kam shkruar sipas qejfit tim
- 12. Keqpërdori ndihmat për Kosovën
- 13. Që të mos flinin me gratë e tyre
- 14. Cipërcullakosje
- 15. Epitete
- 16. Nuk e dinte të mirën, nuk kishte turp

II SERBET E MASKUARA SI KROATE E BOSHNIJAKE

III PREJ NJË SHPATI T'I LËSHOVA SYTË

7. HASAN KADRIU I PRESHEVËS DHE FITIMTARI I 50 MIJË KORONAVE

8. Hajduku i Preshevës, amaneti i Hasan Kadriut!

PARAFJALË

Në librin LUGA DHE LUGINA nuk duhet ngatërruar Ibrahim Kelmendin e LUGINËS së Preshevës, i cili "lindi më **16 prill të vitit 1916 në Preshevë** dhe vdiq më **24 janar të vitit 1979 në Melburn të Australisë**, (ishte antifashist dhe shkrimtar shqiptar) me Ibrahim Kelmendin, që ka të bëjë me LUGËN e Vojvodës Ramë Nikçi.

Ibrahim Kelmendin e Preshevës me Preshevën e lidhë veprimtaria dhe vendlindja e tij, dhe për te bëhet fjalë vetëm në kapitullin e parë. Ibrahim Kelmendin e Llabjanit, në këtë punim, me Preshevën e lidhin çështjet morale të Hasan Kadriut nga Presheva dhe të fejuarës së tij, Fitores.

Ndoshta nuk është lehtë për lexuesit e jashtëm, që prej leximit të parë me i hetua disa detale, e ato janë raporti i Ibrahim Kelmendit (të Llabjanit) me Nexhmi e Shefkate Sherollin, prindërit e Fitores (të fejuarës së Hasan Kadriut).

*Ibrahim Kelmendi: "Udhëtova me Hakanin,, alias Plakun dhe Sarandën, alias Bulen. Në Suedi na pritën bujarisht. Fëllanza me bashkëshortin dhe patriotin e devotshëm, Nexhip Toskën na dhanë **pesëdhjetë mijë korona** suedeze ndihma. Ishte rasti i parë që po na jepej një ndihmë kaq e madhe." (Atentatet, f.391)*

Në citatin e mësipërm janë: Hakani=Hasan Mala; Saranda (Bulja)=Saime Isufi; Fëllanza=Shefkate Sherolli (Suedi me prejardhje nga Mitrovica, nëna e Fitores); Nexhip Toska=Nexhmi Sherolli (Suedi me prejardhje nga Jugu i Shqipërisë, baba i Fitores).

Në gjysëm e dytë të marsit 1982, Ibrahim Kelmendi (pasi është përjashtuar nga shtëpia e Vëllezërve Gërvalla) udhëton në Suedi së bashku me Hasan Malën dhe Saime Isufin. Në praninë e Saime Isufit dhe Hasan Malës, Shefkata dhe burri i saj Nexhmiu (pra prindërit e Fitores) ia japin Ibrahim Kelmendit 50 mijë korona suedeze (sipas kursit të këmbimit - afër 10 mijë dollarë amerikanë apo 22 mijë marka gjermane të asaj kohe) për nevoja të luftës. Të gjitha këto ndihma përfundojnë në xhepin ose lugën e Ibrahim Kelmendit.

Këtë fakt, këtë hajni, për herë të parë e kam marrë vesh nga libri i parë i Faridin Tafallarit, kur e kam lexuar më 1998, dhe në tërësi më është sqaruar në librin Atentatet të Ibrahim Kelmendit. Këto fakte i kanë ditur Hasan Mala, Saime Isufi e Xhafer Shatri, por me ne të Shtutgartit nuk i kanë diskutuar kurrë pasi kanë taktizuar.

Pos tjerash edhe për shkak të kësaj hajnije të 10 mijë dollarëve (pra aq sa kanë bërë 50 mijë korona suedeze në mars 1982), nga marsi 1982, Ibrahim Kelmendi përjashtohet nga Komiteti Qendror i LRSSHJ, në shkurt 1985.

*"Derisa shoku Xhafer (Shatri-shën ynë) në punën e tij që bëri e përcollën edhe gabimet, në anën tjetër shoku Ibrahim Kelmendi nuk punoi fare, por u muar drejtpërdrejt me përcjelljen e punëve dhe gabimeve të Xhaferit; u muar me thash e thëna në mesin e punëtorëve. Bëri edhe dekonspirime të sekreteve të KQ të LRSSHJ-së. **Keqpërdori ndihmat për Kosovën**, duke mos sjellur në fond asnjë qindarkë. P.sh. të përmendim vetëm rastin e **Suedisë** në praninë e katër vetave një familje shqiptare i dha ndihmë luftës sonë prej 50.000 korona, **prej të cilave nuk solli asnjë qindarkë**, si dhe ndihmat që dhanë familjet e tjera në Suedi; mbjellja e frymës përcarëse në vetë KQ; mospërgjegjësia ndaj punës; prishja me miq zviceranë; mosaktiviteti me të huaj dhe krijimi i ftohjes së tyre ndaj luftës sonë dhe organizatës sonë."*

"Kështuqë KQ i LRSSHJ me shumicë votash 4:1 (katër me një) vendosi që shokët Xhafer Shatri dhe Ibrahim Kelmendi përjashtohen nga KQ i LRSSHJ-së, përderisa të mos e vërtetojnë të kundërtën me aktivitetin e tyre. 10 shkurt 1985 Zvicër" (Vendim i Komitetit Qendror të Lëvizjes për Republikën Socialiste Shqiptare në Jugosllavi për përjashtimin e Ibrahim Kelmendit nga KQ, më 10 shkurt 1985. Marrë nga Faridin Tafallari, Terror-Dhimbe-Qëndresë, Tiranë 1997, f.253-254)

Në mesin e atyre që e përjashtojnë Ibrahim Kelmendin nga Komiteti Qendror i LRSSHJ janë Saime Isufi dhe Mustafë Xhemaili. Se çka mendon Ibrahim Kelmendi për ata që e kanë dokumentuar hajninë e tij dhe me të drejtë i kanë kërkuar llogari për te, shihet nga fjalët:

Ibrahim Kelmendi: *"Në xhepat e mijë të grisur nuk ka bir nëne (e as bir kurve), që do mund të kërkonte të hollat e tij ose të hollat e cilido kontribues, që do të thotë se nuk kam shpërdoruar e përvetësuar nga ato mjete për vete dhe as për familje." (Afishuar me: 23.03.2007 21:18, www.kosova.de)*

Tash po dua me u kthye prapë tek marsi dhe vera 1982. Ibrahim Kelmendi, i cili në mënyrën e vet e plaçkitë familjen e Shefkate e Nexhmi Sherollit duke ua marrë 10 mijë dollarë, u premton se do të angazhohet me ua "rahatua" vajzën Fitoren me ndonjë patriotë e aktivist të dalluar të Lëvizjes, pasi ata "familjes së Lëvizjes" ia kanë dhënë 10 mijë dollarë (50 mijë korona suedeze). Pra vet I. K. i njofton dhe e organizon lidhjen e Hasanit dhe Fitores. Unë në këto çështje nuk kam qenë fare i involvuar. Kur vjen deri tek prishja, këtë çështje private, Ibrahim Kelmendi mundohet me e shndërrua në çështje shoqërore dhe problem të Lëvizjes, përmes letrës së tij të 14 prillit 1983, që është letra e parë që më është dërguar prej tij, dhe fillimi i korrespondencës sime me te në kuadër të Qendrës Ekzekutive dhe ka zgjatë deri më 19 mars 1984. Pra letra e parë (njëkohësisht edhe hapi e iniciativa e parë) prej Ibrahimit është ajo e 14 prilli 1983 dhe e fundit, më 19 mars 1984. Shokët e Ibrahim Kelmendit dhe Hasan Kadriut në Zvicër, e në të njëjtën kohë anëtarë të Qendrës Ekzekutive (Xhafer Shatri dhe Hasan Mala) nuk pranojnë me bisedua me Ibrahim Kelmendin për këtë çështje. Letrës së tij të parë, të 14 prillit 1983 iu kam përgjegjur me letrën time të parë që ia kam dërguar I.K. më 24 prill 1983, një pjesë e së cilës e ka këtë përmbajtje:

Xhafer Durmishi: *"Shoku I. (Ibrahim Kelmendi)*

24 prill 1983

... Nuk është nevoja që shumë gjëra t'i përsëris apo të shkruaj siç thua ti, fraza rasti. Në bazë të kontakteve dhe vendeve që jemi takuar mund të them se relativisht njihemi mirë. Kemi vendosur me luftuar se bashku dhe këtë do ta bëjmë. Ku kanë qenë punët para një viti dhe ku janë sot e ke ditur e edhe sot e dinë se ku janë qoftë në planin

e përgjithshëm qoftë në atë konkret të relacioneve në mes kuadrove. Është mirë edhe me e paramenduar se në çfarë situatë do të ndodhemi pas një ose dy vitesh. Kjo mvaret në masën më të madhe prej nesh.

Ne njihemi vetëm sa na ka kontaktuar puna dhe vetëm puna e asgjë tjetër. Në bazë të saj do të njihemi edhe në të ardhmen.....

Të fala S. (Salihu=Xhafer Durmishi)" (PA TAKTIZIME, faqe 17-18, pashtriku.org, prill 2012; Vërjetje titulli i librit "PA TAKTIZIME" është marrë duke u bazuar në përmbajtjen e kësaj letrë të 24 prillit 1983).

Me kohë, më duket se do të shihet më lehtë çështja ashtu si është: Një familje që i ka dhënë luftës shumë është plaçkitur materialisht dhe keqpërdorur në forma tjera. Është domethënëse fakti se si hajni dhe plaçkitësi i familjes së Fitores është në të njëjtën kohë edhe kavaleri, gjentelmeni e mbrojtësi i moralit të Fitores. Pse ndodhë kështu? Sepse:

Ibrahim Kelmendi: "Uroj, që kur të krijohet distanca e bollshme kohore, të bëhen vlerësime kritike, edhe pse thuhet se "historinë e shkruajnë fitimtarët". (Bedri Islami, Lëvizja, Tetovë, 2012, faqe 13)

1. Ibrahim Kelmendi - Vetëtimja e Luginës së Preshevës



Ibrahim Kelmendi

Marrë nga "http://sq.wikipedia.org/wiki/Ibrahim_Kelmendi"

Nga Eugen Shehu.

Ibrahim Osmani-Kelmendi lindi më 16 prill të vitit 1916 në Preshevë dhe vdiq më 24 janar të vitit 1979 në Melburn të Australisë, ishte antifashist dhe shkrimtar shqiptar.

Fëmijëria e Ibrahim Kelmendit kishte rrjedhur përmes lodrave të pakta dhe halleve të shumta që kishte vendlindja e tij - Presheva, por dhe krejt atdheu shqiptar, pas përfundimit të luftës së Parë Botërore. Pas mbarimit të shkollës fillore në Preshevë, Ibrahim vendos të studiojë në gjimnazin e medreses në Shkup. Studimet universitare për histori i filloi në Beograd. Megjithatë nxënës i shkëlqyer në gjimnazin e Shkupit, dëshira e tij për historinë e luftërave ballkanike dukej se po daravitej nën peshën e falsifikimeve. Veçmas historia e kombit tonë, masakrohej nëpër katedrat e ftohta të Beogradit duke i kujtuar Ibrahimit mendimin e gabuar sipas të cilit të mëdhenjtë gjithmonë kanë të drejtë. Një mikut të tij në Universitet do ti thoshte një ditë në intimitet „Historia jonë flet

ndryshe. Besa unë kam me i besue deri në mortë këngëve dhe rrëfimeve që kam ndier për së vogli në Preshevë, e kurrë s'kam me u hap rrugë përrallave të shkja, atyre mbeturinave të Karpateve".

Pa disa kërkesave të rreshtura largohet nga Beogradi dhe fiton të drejtën për të vazhduar studimet për histori në Universitetin e njohur të Peruxhës në Itali.

Fytyra e tij gjithmonë e qeshur do të vërehej teksa i tërhiqej vërejtja në organet drejtuese të Universitetit për „irredentizëm”. Por djaloshi preshevar nuk mund të durojë gjatë, ai flet hapur, godet dhe injoron fashizmin duke paracaktuar se „shumë shpejt ushtarët italianë do ti lënë kockat nëpër dhera të huaja. I përjashtuar nga Peruxha, vitin e fundit universitar, Ibrahim Kelmendi e vazhdon në Zagreb ku dhe diplomon. I kthyer nën qiellin e atdhetarizmit dhe patriotizmit shqiptar, do të caktohet të punojë në Liceun e parë në gjuhën shqipe të hapur në Prishtinë në fillimin e viteve 1940. Bashkëpunon sidomos me drejtorin e atëhershëm të Liceut, Dr. Rexhep Krasniqin, një nacionalist dhe patriot i flaktë, lidhur me tezat kryesore të historiografisë shqiptare.

Krah më krah me nacionalistët e tjerë të Ballit , rrëmben pushkën dhe krismat e saja do të dëgjohen përherë e më fort në Preshevë, Gjilan, Budrikë , Bujanoc, Sharr e Drenicë si dhe në gjitha trojet ku flitej shqip. Si anëtarë i Komitetit Qendror të Ballit Kombëtar për Kosovë pas përforcimit të mbrojtjes kufitare të trojeve etnike, prof. Kelmendi do të kalojë me instruksionet e tija në Karadak e Sharr, do të ndihmojë Mulla Idrizin e Xhemë Gostivarin, do të marrë pjesë në betejën e Ferizajit me rininë Nacionaliste së bashku me prof. Luan Gashin e Abdyl Hencin e nacionalistët e tjerë.

Prof. Ibrahim Kelmendi me urdhër të Qendrorit të Organizatës së Ballit Kombëtar, me dhimbje dhe pa dashje lë vendlindjen dhe atdheun, për të kaluar ditët më të bukura të rinisë së vet, në kampet e refugjatëve politik në Greqi. Disa vite më vonë më 1953, i plotësohet kërkesa dhe shkon në Australi ku menjëherë falë aftësive të tij fillon punën si pedagog në njërin prej gjimnazeve të Melburnit.

Me sy nga Presheva, me flakën e pashuar për lirinë e atdheut të vet, në shtatorin e vitit 1979 ndërron jetë, duke u treguar shqiptarëve se gjurmët e tij, gjurmët e vetëtimës së Preshevës janë në çdo vis ku luftohet dhe jetohej për lirinë, bashkimin dhe prosperimin e kombit shqiptar. A do të ngeli ende në heshtje kjo vetëtimë me zemër vigani, kjo figurë e nacionalizmit shqiptar ? Kjo ngel në ndërgjegjen e intelgjencës preshevare në radhë të parë e mëndej instituteve historike shqiptare. Ideali dhe vepra e tij, le të ngeli një udhëndriçim për gjeneratat e sotme dhe të nesërme.

Nga Eugen Shehu. (http://sq.wikipedia.org/wiki/Ibrahim_Kelmendi)

2. DO TA DISKREDITOJA EDHE PËR SË VDEKURI PËR TË PABESË E INTRIGANT

Bedri Islami: - *Pas botimit të romanit "Atentatet" ju u ndodhët edhe një herë në dy kahe: në përgëzimin e shumë prej atyre që i kishin përjetuar ngjarjet bashkë me ju, si Saime Isufi apo Mustafë Xhemajli, por edhe në ciklin e radhës së sulmit ndaj jush, nëse mund ta quaj kështu. Mes të tjerave, në një material, i cili po përhapet tashti, nuk e di nëse është i saktë, bëhet fjalë për lidhjen fisnore me Ramë Nikqin ose Ibërdemaj, i cili, siç e cilëson Xhafer Durmishi, me siguri "analisti" më i zellshëm i romanit tuaj, ishte agjent i UDB-së.*

Ibrahim Kelmendi: - *Pas botimit të romanit "Atentatet" ka pasur vërtet reagime të llojllojshme dhe, me thënë të drejtën, më kanë gëzuar. Ato ishin një dëshmi se nuk e kisha shkruar vetëm sa për ta shkruar. Pas dy muajve romani u shit dhe shpesh ndihem*

keq kur të interesuarit e tjerë e kërkojnë dhe unë nuk kam asnjë kopje. Shtëpia botuese "Toena" e Tiranës ka premtuar ta ribotojë.

Tani ka shkruar një reagim të gjatë Xhafer Durmishi, ish-bashkëveprimtar, njëkohësisht ish-kundërshtar i imi. Sa për shembullin që sollët ju për sqarim, unë nuk do t'i isha hidhëruar fare Xhaferit, sikur të kishin qenë shpifje të tij autentike, ngaqë ndaj tyre kam krijuar imunitet. Tani më shqetëson fakti se ato shpifje i vishen Jusufit, të cituar në bazë të një "raporti" që gjoja ai i paskësh dërguar Sabri Novosellës. Fillimisht dëshiroj të shpreh vlerësimin se atë "raport" nuk e ka shkruar fare Jusufi, meqë nuk është në fahun, në germën dhe në frymën e tij. **Po ta kishte shkruar vërtet ai, nuk do të ngurroja ta diskreditoja, edhe për së vdekuri, PËR TË PABESË E INTRIGANT.**

... Mjafton të them se Jusufi e ka ditur shumë mirë kush ishte Ramë (Idriz) Ibërdemaj, prandaj nuk ka pasur nevojë të hamendesohet nëse ishte Ramë Ibërdemaj apo Ramë Nikqi.

...Dihet, dajën nuk e zgjedh dot. Jusufit nuk do t'i kishte shpëtuar kjo lajthitje, edhe po të kishte qenë i pabesë dhe intrigant dhe të kishte përpiluar të tillë "raport" kaq diskreditues, së pari për veten e tij. Pra, kjo lajthitje është prodhuar nga falsifikuesi, i cili ngjan të jetë vetë Xhafer Durmishi, meqë e citon rreth 100 here atë "raport" në "librin" e tij, me titull hileqar e intrigues: "Lëvizja e Jusuf Gërvallës".

...Po ta kishte publikuar këtë "libër" Xhafer Durmishi para se ta kisha shkruar romanin "Atentatet", sigurisht, unë do ta kisha mënjeluar Ramë Ibërdemajn si personazh të romanit, për inat të Xhaferit. Prandaj, edhe për inat të Xhaferit, me këtë rast dua t'u kërkoj falje fëmijëve të respektuar të dajës Ramë, pse e kam diskredituar atë në roman si të dyshimtë për bashkëpunëtor të UDB-së. Vetëm për Haki (Ramë) Ibërdemajn, të cilin një spiun i UDB-se e vrau në Bruksel, sigurisht që kisha dhënë



Vepra të UDB-së së Serbisë ndaj shqiptarëve të Kosovës, Pranverë 1999

një tren me xhafera...!" (Bedri Islami, LËVIZJA, Tetovë 2012, faqe 114-117)

Nëntitujt dhe përmbajtja e njësive "Çdo të thotë fjala vojvodë?" dhe "Kush është vojvoda Ramë Nikçi?" janë marrë nga shkrimi i Ibrahim Kelmendit me titull "KLIKA E BEOGRADIT – Të vret natën, të këndon ditën..." në 6 faqe të formatit A5, i shpërndarë në maj 1982, në emër të "Punëtorët shqiptarë në mërgim".

3. Çdo të thotë fjala vojvodë?

Vojvodë është gradë ushtarake në mbretërit serbe e malazeze. Këtë fjalë do ta gjejmë të sqaruar në "Ilustrovana politika" të Beogradit. Por për çudi, kur klika serbomadhe ka ndërmarrë fushatë hysterike kundra "nacionalizmit romantik" shqiptar, si nuk u bie fjala vojvodë në sy, që nuk ka të bëjë vetëm me nacionalizmin serb. Për këtë nuk kanë frikë as gazetari shovenist Zec as vojvoda Ramë, që e përdorin me krenari.

"... Vojvoda rugovas, shkruan "ilustrovana politika" (më 26.05.81), është përfaqësuesi i tanishëm "lozës" (serbisht: loza), e cila që nga kohërat turke ruan qetësinë dhe paprekshmërinë e Patriarkanës...)

Siç na del, vojvodët kanë qenë rojë e rendit, ndërsa vojvodët e familjes Nikçi (nga Shtupeçi i Madh, fshat i Rugovës) kanë qenë rojë besnike e Patriarkanës, të ndërtuar nga Dushani, për ta përjetësuar robërinë e "stara Serbisë" (siç e quajnë shovenistët Kosovën.).

4. ATY KA QENË EDHE LUGA E VOJVODËS

-KUSH ËSHTË VOJVODA RAMË NIKÇI?

Të shkruajmë se kush është vojvoda Ramë Nikçi nuk e kemi vështirë, pasi ai vetë na e ka lehtësuar këtë, duke përmbledhur historinë e vetë e të familjes në bisedën dhënë "ilustrovana politikës" së Beogradit, Nr. 1177, të 26.05.81. Pos kësaj bisede, ai në rrethin e Pejës është ndër më të kompromituarit. Sa ai është edhe vetëm udbashi rankoviçevës Bajram Dreshi. Të dy së bashku, me ca të tjerë, Rugovës ia njollosin emrin e pa njollosur, pse bijtë e bijat i dalin asaj zot.

Në artikullin e revistës në fjalë, "Besa nije vraçena" lexojmë:

"Ramë Nikçi është shefi shërbimit juridik ndërkomunal pranë Entit për Inkuadrim në Pejë..." Siç e pamë më lartë, është përfaqësuesi i tanishëm i "lozës" për ta mbrojtur Patriarkanën.

Në pyetje të gazetarit, se a ka marrë pjesë ndonjë rugovas në demonstrata "nacionaliste", vojvoda përgjigjet: "Po. Të tillëve ju takon sipas ligjit nga qeveria, kurse nga rugovasit – bojkotimi (izolimi). Në shtëpitë s'do hynë askush, dërisa Plegësia jotë të mos vendos ndryshe. Nga vllazëria ime Nikçi nuk ka asnjë demonstrues. E kam vërtetuar dhe për këtë jap fjalën. Askush nga anëtarët e SHKA "Rugova" s'ka marrë pjesë në demonstrata. Më është bërë qefi..." Pastaj vazhdon vojvoda: "Ishim dy herë si shoqëri mysafirë në RPS të Shqipërisë. Këtë vit shqiptarët është dashur të na e kthejnë vizitën, por le të mos vinë..." Më poshtë vijon vojvoda: "... Çka u duhet këtyre demonstruesve që kërkojnë t'i bashkangjiten Shqipërisë (...). Këtë liri, siç e kanë shqiptarët në Jugosllavi, nuk e kanë patur asnjëherë askund dhe secili që mendon ndryshe – është njeri i keq..."

Gazetari pyet: "Babën tëndë, gjithashtu vojvodë rugovas, e kanë vrarë në pritë në vitin 1939. Kush dhe përse?"

Ramë vojvoda përgjigjet: "Kanë vrarë babën tim me dy mixhallarë, para syve të mij, brenda gjysmë ore. Ka qenë larje llogarish me fiseve, nuk ka qenë hakmarrje gjaku.

U ka penguar (menohen "vrasësit") pse baba ka qenë vojvodë rugovas, që ka ruajtur (nënvizimi ynë) Patriarkanën e Pejës..." Pastaj vojvoda vijon me nostalgji çetnike:

"... Me konakun e vjetër të kishës m'është djegur edhe dhoma në të cilën kam banuar prej 1941-tës e dëri në mbarim të Luftës. Në të ka qenë kërveti, në të cilin kam fjetur, aty ka qenë edhe LUGA me të cilën kam ngrënë dhe fotografitë e t'parëve të mij. Të gjitha janë djegur..."

Artikulli mbaron me fjalët e vojvodës Ramë: "Unë i dua (nënvizimi ynë) shumë fjalët e Mark Milanit..." (Ato s'po i citojmë – Shtojmë se Mark Milani ka qenë komandant i forcave pushtuese malazeze, në luftë për t'i pushtuar Plavë, Gusi, Hot, Grudë e Rugovë...).

E cituam si shumë artikullin në fjalë pse u pa e arsyeshme përmes të kësaj reviste çetnike, gjegjësisht përmes fjalëve të vojvodës, ta njohim udhëheqësin e SHKA "Rugova", i cili, sipas "Pravosllavjes" (Gazetë kishtarë serbe, "kur ka parë konakun në flakë ka qa." Vojvoda kësaj radhe "demanton" atë çka ka shkruar "Pravosllavja", duke thënë se rugovasi nuk qajnë kur t'u ndodhin fatkeqësi të rënda...

"Patriotizmi" serb i Ramë vojvodës, siç na bind ky artikull dhe profesioni i tij si vojvodë, ia kalon "patriotizmit" serb të shumë çetnikëve, të cilët nuk kanë bërë dhe s'do bëjnë aq sakrificë për ta mbrojtur kishën, sa bëri familja Nikçi (nga Shtupeqi i Madh). Krenaria e Ramë Nikçit si vojvod... për ta mbrojtur Patriarkanën...!!

Duket së nana e Ramës kur ka dashur të kryen nevojë (me nder me then) në vend të m... ka pjellur rastësisht vojvodën..." (Mbarimi i citatit)

Nëntitujt dhe përmbajtja e njësive "Çdo të thotë fjala vojvodë?" dhe "Kush është vojvoda Ramë Nikçi?" janë marrë nga shkrimi i Ibrahim Kelmendit me titull " KLIKA E BEOGRADIT – Të vret natën, të këndon ditën..." në 6 faqe të formatit A5, i shpërndarë në maj 1982, në emër të "Punëtorët shqiptarë në mërgim"

Jusuf Gërvalla (raport): "Me përfaqësuesin e Frontit të Kuq Popullor, Ibrahim Kelmendin, jam njohur në janar të vitit 1980. ...

Është nip i një agjenti me zile të UDB-së, i quajtur Ramë Nikçi ose Ibërdemaj, punon në postën e Pejës. I biri i këtij Ramës ndodhet me punë në Mynhen dhe ka qenë aktivist i dalluar, madje edhe kryetar klubi në Mynhen." (www.albaniapress.com, 2 tetor 2011; Faridin Tafallari, Kur Jusuf Gërvalla shkruante)

5. Prej gjyshit Ibush deri te djali i Dajës Ramadan

Gjyshi Ibush, Daja Ramadan, dhe Garipi djali i Dajës Ramadan

Ibrahim Kelmendi: "– Ju kërkoj juve, Zotëri Fekir Dalana, – iu përgjigj sërish me qetësi të madhe Mirani.

– Unë nuk jam Fekir Dalana dhe juve nuk po ju njoh fare! – foli ai pa mundur ta fshihte gënjeshtren e tij naive.

*– Si nuk më njihke? Jam nipi i ish-kolegut tënd, Dajës Ramadan. Tani sigurisht po të kujtohem. Sa herë ju kam bërë kafe kur vinit te gjyshi **IBUSH** dhe ju me lavdëronit për kafet e mira.*

– O, po, më fal, urdhëro nipash, tani po më kujtohesh, – tha Fekiri duke hapur derën dhe duke u munduar të zgërdhihej sikur po i bëhej qejfi që po e vizitonte Mirani.

Mirani u fut brënda duke u bërë se ishte i gëzuar që po takonte pas shumë vjetëve kolegun e shokun e Dajës Ramadan. U përqaftuan dhe Mirani zuri vend aty ku e drejtoi

mikpritësi. Ndërruan fjalët përshëndetëse duke pyetur për hallet, jetën etj. Pastaj Mirani hapi bisedën për qëllimin e ardhjes.

– Zotëri Fekir Dalana, të përgëzoj që je zgjedhur kryeredaktor i Organit “Besa Shqiptare”. Më është bërë qejfi që jeni zgjedhur pikërisht Ju, meqë ju njoh që moti për patriot. Për ju më ka folur shumë Daja Ramadan dhe bile, kur fola para dy ditëve me të në telefon, më porositi t’ju përshëndes, meqë i tregova se do të vija në Vjenë.” (Atentatet, f. 75)

Ibrahim Kelmendi: “Në Mynhen jemi duke u përpjekur të marrim Klubin “Rilindja”. Ai vazhdon të jetë nën tutelën e konsullatës jugosllave. Aty ka qëlluar djali i Dajës Ramadan, Garipi, kryetar, për të cilin ke dëgjuar.” (Atentatet, f.191)

Ibrahim Kelmendi: “Fillimisht dëshiroj të shpreh vlerësimin se atë “raport” nuk e ka shkruar fare Jusufi, meqë nuk është në fahun, në germën dhe në frymën e tij. Po ta kishte shkruar vërtet ai, nuk do të ngurroja ta diskreditoja, edhe për së vdekuri, për të pabesë e intrigant.” (Bedri Islami, Lëvizja, Tetovë 2012, f.115)

Jusuf Gërvalla (raport): “Me përfaqësuesin e Frontit të Kuq Popullor, Ibrahim Kelmendin, jam njohur në janar të vitit 1980. ...

Është nip i një agjenti me zile të UDB-së, i quajtur Ramë Nikçi ose Ibërdemaj, punon në postën e Pejës. I biri i këtij Ramës ndodhet me punë në Mynhen dhe ka qenë aktivist i dalluar, madje edhe kryetar klubi në Mynhen.” (www.albaniapress.com, 2 tetor 2011; Faridin Tafallari, Kur Jusuf Gërvalla shkruante)

Jusuf Gërvalla flet, e cilëson Ramë Nikçin si agjent me zile të UDB-së. Ibrahim Kelmendi e demaskon në gjuhën shqipe Ramë Nikçin si Vojvodë e bir Vojvode të kralëve të Serbisë. Unë këtu nuk e di nëse Daja Ramë, si agjent me zile i UDB-së, i Jusufit, a është në të njëjtën kohë edhe Vojvoda i Ibrahim Kelmendit, apo Vojvoda dhe agjenti me zile janë dy Ramë Nikça të ndryshëm.

6. PORTRETE FEMRASH

Në librin *Atentatet* të Ibrahim Kelmendit dhe diskutimet rreth tij

I KURVA, KURVARË DHE KURVËRIME

- 1. Shqiptarët kurvarë garonin midis tyre
- 2. Faturat përmbajnë tatimin e vlerës së shtuar
- 3. A të fascinoi edhe për bixhoz dhe kurvëri
- 4. U tërbova duke i thënë kurvar
- 5. Sa për kurvërim të kam ty këtu më afër
- 6. Kapni kurvarët që jua bënë shoshë gratë e vajzat
- 7. Nuk ka bir nëne e as bir kurve
- 8. Shkrimtari harton fabula
- 9. Qenke njeri i poshtër
- 10. Pa pretendim për të qenë të vërteta historike
- 11. Mos më keqkuptoni, por kam shkruar sipas qejfit tim

- 12. Keqpërdori ndihmat për Kosovën
- 13. Që të mos flinin me gratë e tyre
- 14. Cipërcullakosje
- 15. Epitete
- 16. Nuk e dinte të mirën, nuk kishte turp

II SERBET E MASKUARA SI KROATE E BOSHNIJAKE

III PREJ NJË SHPATI T'I LËSHOVA SYTË

I

KURVA, KURVARË DHE KURVËRIME

Të gjitha citatet (me përjashtim të atij rreth dramës Misioni të Sabri Hamitit) nuk kanë asnjë koment përveç titujve që kanë për qëllim lehtësimin e dukjes së citateve.

KOMITETI QENDROR I LRSSHJ " Keqpërdori ndihmat për Kosovën, duke mos sjellur në fond asnjë qindarkë. P.sh. të përmendim vetëm rastin e Suedisë në praninë e katër vetave një familje shqiptare i dha ndihmë luftës sonë prej 50.000 korona, prej të cilave nuk solli asnjë qindarkë, si dhe ndihmat që dhanë familjet e tjera në Suedi." (Vendim i Komitetit Qendror të Lëvizjes për Republikën Socialiste Shqiptare në Jugosllavi për përjashtimin e Ibrahim Kelmendit nga KQ, më 10 shkurt 1985. Marrë nga Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, f.253-254)

I. Kelmendi: "Në xhepat e mijë të grisur nuk ka bir nëne (e as bir kurve), që do mund të kërkonte të hollat e tij ose të hollat e cilido kontribues, që do të thotë **se nuk kam shpërdoruar** e përvetësuar nga ato mjete për vete dhe as për familje." (Afishuar me: 23.03.2007 21:18, www.kosova.de)

Daut Demaku: "**Dimensioni politik i romanit "Atentatet" është aq i thellë dhe aq domethënëse sa iu mbetet studiuesve të rinj që ta zbërthejnë në qetësi, sepse brumi është aq i vërtetë, aq konkret dhe aq i bollshëm sa mjafton për gatime të të gjitha veprave politike, juridike, kriminalistike, psikologjike..."** (Prishtinë, 26 gusht 2007, www.pashtriku.org)

-1. Shqiptarët kurvarë garonin midis tyre

Gjatë marrjes në pyetje, në Vjenë, të kolegut të Dajës Ramadan nga posta e Pejës, i cili i zënë ngushtë betohet në kokën e vajzës

I. Kelmendi: "Betimi në kokë të vajzës e neveriti Miranin, meqë kishte dëgjuar se ajo

po ushtronte prostitucion në Vjenë. I kishin thënë se ishte e pashme e tërheqëse dhe se shqiptarët **kurvarë** në Vjenë garonin midis tyre që t'i jepnin asaj shilinga dhe të krekoseshin para njëri-tjetrit." (Atentatet, f.80)



Aparat për regjistrimin e hyrje-daljeve, i aprovuar nga organet tatimore

-2. Faturat përmbajnë tatimin e vlerës së shtuar

I. Kelmendi për vetveten dhe për kurvarët profesionist që mbajnë kontabilitet e i paguajnë tatimet dhe sigurimet sociale me rregull

I. Kelmendi: "Se si po më vjen keq që qenka katandisur në atë gjendje. Më drejtohet duke më poshtëruar, se dashka të bëka seks **më mua**, meqë nuk paska të holla për të paguar mashkull **kurvar**, nga ata që e kanë si marrëdhënie pune dhe paguhen

nga femrat për të dëfryer ato kur kanë deficit seksual. Edhe ato fatura të pagesës përmbajnë **tatimin e vlerës së shtuar**, që duhet t'ia paguajnë shtetit, njësoj si edhe prostitutat e legalizuara që paguajnë të gjitha sigurimet sociale dhe tatimin vjetor mbi fitimin." (Atentatet, f.95)

-3. A të fascinoi edhe për bixhoz dhe kurvëri Për Sadik Blakajn

Ibrahim Kelmendi: "– Pse nuk po flet? – ia ndërpreu Vasili mendimet.

– Po atëherë çfarë ndodhi?

– Vërtet, Sadiu erdhi pas dy ditëve. Ndenjëm ca ditë bashkë te Demushi në Nagold. Atje u fascinoi nga shkathtësitë dhe patriotizmi i tij. Kishte shkathtësi të falsifikonte dokumente të të gjitha llojeve. Madje edhe bileta të trenit. Kishte shkathtësi për të qenë gueril i përkryer...

– A të fascinoi edhe për bixhoz dhe **kurvëri**, sepse kohën më të madhe e kalon me to? f.180

"– Po bëhem kurban,– ndërhyri Vasili.– Më mirë unë se ti dhe Baca Jusuf.

– Çfarë rëndësie ka kjo provë naive e shoqëruar me rrezik të qind për qindtë!? Në fakt, përse po na duhet ky farë Sadiu!? Ti vetë duhej të ishe bindur të paktën se ai është **kurvarë**, bixhozxhinj, rrugaç! – i foli rrebtë Mirani." (Atentatet, f.182)

-4. U tërbova duke i thënë kurvar

Rreth fatit të një femre në duart e UDB-së e cila nga Kosova është nis enkas me plan të martohet me figurën frontale të Frontit të Kuq

Ibrahim Kelmendi: "Menjëherë u tërhoja duke i thënë pusht, **kurvar** e të ngjashme. Bëra të iki, por ai e kishte mbyllur derën dhe çelësin e kishte futur në xhep." (Atentatet, f. 204)

-5. Sa për kurvërim të kam ty këtu më afër (Në bisedë me heroinën e vetë Renatën)

Ibrahim Kelmendi: "– Edhe ty nuk të shkoi mendja aq afër dhe aq qëllueshëm. Unë të fola për lisa, kurse ti më flet për fshesa, siç shprehet populli ynë. A nuk e kisha Martën këtu, e cila më përgjyerohej, **pa pagesë**. Atëherë, përse u dashka të shkoj deri në Berlin për **kurvërim**? E di ti sa janë shpenzimet e udhëtimit deri atje dhe si keqtrajtohesh kur kalon transit nëpër Gjermaninë Lindore? Pastaj, po të **kisha kurvërimin si qëllim, a nuk të kam ty këtu më afër?**

– Stop! Stop! Mua kurrësi për **kurvërim**. More vesh!?

– Stop! Stop! Ti e nise e para dhe më ofendove." (Atentatet, f.214-215)

KOMITETI QENDROR I LRSSHJ " Keqpërdori ndihmat për Kosovën, duke mos sjellur në fond asnjë qindarkë. P.sh. të përmendim vetëm rastin e Suedisë në praninë e katër vetave një familje shqiptare i dha ndihmë luftës sonë prej 50.000 korona, prej të cilave nuk sollli asnjë qindarkë, si dhe ndihmat që dhanë familjet e tjera në Suedi." (Vendim i Komitetit Qendror të Lëvizjes për Republikën Socialiste Shqiptare në Jugosllavi për përjashtimin e Ibrahim Kelmendit nga KQ, më 10 shkurt 1985. Marrë nga Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, f.253-254)

I. Kelmendi: "Në xhepat e mijë të grisur nuk ka bir nëne (e as bir kurve), që do mund të kërkonte të hollat e tij ose të hollat e cilido kontribues, që do të thotë **se nuk kam shpërdoruar** e përvetësuar nga ato mjete për vete dhe as për familje." (Afishuar me: 23.03.2007 21:18, www.kosova.de)

-6. Kapni kurvarët që jua bënë shoshë gratë e vajzat

Në doganën e Gjermanisë Lindore (DDR)

I. Kelmendi: "Atëherë, i thashë, kapni **kurvarët** që jua bënë shoshë gratë e vajzat, duke i paguar devizat që ndërrojnë në treg të zi." f.216

"Ju përgjigja se nuk kisha menduar ashtu, por se doja t'ju thosha t'i pengoni **kurvarët** që po vijnë, po bëjnë kontrabandë dhe po jua provokojnë gratë e vajzat me para." (Atentatet, f.216)

-7. Nuk ka bir nëne e as bir kurve

KOMITETI QENDROR I LRSSHJ " Keqpërdori ndihmat për Kosovën, duke mos sjellur në fond asnjë qindarkë. P.sh. të përmendim

vetëm rastin e Suedisë në praninë e katër vetave një familje shqiptare i dha ndihmë luftës sonë prej 50.000 korona, prej të cilave nuk solli asnjë qindarkë, si dhe ndihmat që dhanë familjet e tjera në Suedi." (Vendim i Komitetit Qendror të Lëvizjes për Republikën Socialiste Shqiptare në Jugosllavi për përjashtimin e Ibrahim Kelmendit nga KQ, më 10 shkurt 1985. Marrë nga Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, f.253-254)

I. Kelmendi: "Në xhepat e mijë të grisur nuk ka bir nëne (e as bir kurve), që do mund të kërkonte të hollat e tij ose të hollat e cilido kontribues, që do të thotë se nuk kam shpërdoruar e përvetësuar nga ato mjete për vete dhe as për familje." (Afishuar me: 23.03.2007 21:18, www.kosova.de)

-8. Shkrimtari harton fabula

Mustafë Xhemali: "Skema e famshme e Aristotelit lidhur me historinë dhe letërsinë është e qartë. Ajo nuk ka ndryshuar as sot dhe është kështu: **Historia tregon atë që ka ndodhur, ndërsa letërsia (poezia) tregon atë që mund të ndodhë**; historia tregon çka ngjet, letërsia tregon si mund të ngjajë; historia tregon gjëra të veçanta, letërsia tregon gjëra të përgjithshme, prandaj letërsia është më filozofike se historia. Më tutje: historiani shënjon referencat (të dhënat), **shkrimtari shënjon tekstin fiktiv**, të mundshmen; **historiani nuk harton fabula, kurse shkrimtari harton fabula**. Edhe më tej: historia mund të jetë e shkruar në vargje e të mos bëhet letërsi. Sepse e para mbështet te e vërtetdukshmja (që do të thotë e mundshme) kurse e dyta në ngjashmëri (që do të thotë e besueshme). (shih te **S. Hamiti: Tematologjia, f.70**). (Atentatet e zbuluara - Fjala promovuese më 14 prill 2007 në Dyzeldorf (Gjermani), për romanin e Ibrahim Kelmendit ATENTATET, www.pashtriku.org)

-9. Qenke njeri i poshtër

Atyre që ju intereson teoria e letërsisë mund shohin çka thotë Sabri Hamiti tek "Tematologjia f.70". Atyre që u intereson Drama e 17 janarit 1982, mund të shohin tek drama Misioni, pjesa e parë, skena IV, ku flitet për Ibrahim Kelmendin (**Keqën**), Kadri Zekën (**Lulin**), Jusufin (**Isën**) gruan e Jusufit (**Zanën**) dhe gruan e Kadri Zekës (**Lulën**). Pa komentuar aspekte tjera, interesant është 'respekti' për gratë, të cilin Sabri Hamiti duhet ta ketë mësuar nga burimi i tregimit të tij. Për hir të qartësisë brenda citateve në kllapa janë vënë emrat e personazheve të vërteta.

Pjesët e cituara paraqesin biseda në shtëpinë e Jusufit në mesditën e 17 janarit 1982.

Keqa nuk mund të jetë i keq

Sabri Hamiti: "ZANA (Suzana), hap derën, fut kokën.

Mirëdita të gjithëve!

KEQA (Ibrahim Kelmendi), Zanës.

Hyn fisnike vetëm një minutë. *Ia shtrin dorën, përshëndetet, mandej ulet.* Këtij Lulit tonë po i ngutet. Si e pleqnon ti fisnike këtë punë? *Zana rrudhë krahët. Ky e ka mendjen te Lula e vet e re që ia ka lënë shtratin thatë. Qetësi.* Unë jam kalli vetëm dhe s'kam çka të ngutem. E kam nanën vejushë të cilës s'mund t'ia gjej një plak. E kam edhe një motër, e sa për motër moj fisnike ia kam gjetur burrin. Ha-ha-ha. Do ta bëjmë dhëndër Isën për së dyti. *Isa hesht. Shikon Zanën, e cila pa asnjë fjalë del.*

LULI (Kadri Zeka), i mërdhezur.

E mira e të mirave po të lut, Lulën mos e përmend.

ISA (Jusuf Gërvalla), mban veten.

Të lutem Keqë, **respekt për shtëpinë, konakun, për femrën.** Të gjithë jemi me nerva, **por kjo është shtëpi.**" (Misioni, Prishtinë 1997, faqe 41)

Sabri Hamiti: "KEQA (Ibrahim Kelmendi), dredhas.

Ky prapë nuk e ka mendjen këtu. Ha-ha-ha. E ka mendjen te shtrati i thatë i Lulës.

LULI (Kadri Zeka), e gjuan fytyrës me bllok.

Qenke njeri i poshtër!" (Misioni, Prishtinë 1997, faqe 46)

S.H.: "Keqa nuk mund të jetë i keq" (Misioni, faqe 49)

Dordoleci superior i UDB-së Serbe dhe Vëzhguesi i tij superior: "Në këtë pozitë inferiore nga ana e „zëvendësit“, ndjehej edhe udhëheqësi i FKP-së, Ibrahim Kelmendi." (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, 2010, f. 89)

Ibrahim Kelmendi: "Sadik, ...Gjithsesi, çdo gjë do nxjerrë koha në dritë, por ti duhet të provosh menjëherë ta përshkruash ngjarjen pastaj të shohim: **ndoshta je i pastër si loti dhe mbetemi shokë të mirë.** Për të ardhur gjer tek kjo, do të ishte dashur një sinjeritet i thellë, duke pranuar edhe ndonjë gabim të vogël nga mosdija..." (Letër për Sadik Blakajn më 21 janar 1981. Marrë nga Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, faqe 407)

-10. Pa pretendim për të qenë të vërteta historike

Ibrahim Kelmendi: "Ato (ngjarjet-shën. i Xh. D.) janë paraqitur ashtu siç i kam përjetuar dhe siç i kam mbajtur mend, **pa pretendim për të qenë të vërteta historike.**"(kopertina e mbrapme e romanit Atentatet)...*"romanin e kam shkruar sipas qejfit".*

Ibrahim Kelmendi: "Mirani mori frymë thellë për të pritur reagimin. Kishte frikë mos po e humbiste durimin, pasi ishte bindur se shtabi i UDB-së që kishte urdhëruar atentatet, tani kishte dhënë urdhër që të provokohej Mirani për të bërë ndonjë hata ndaj provokuesve.

– Jo vetëm ti, por as ajo **kurva**, që ju po i thoni Bule, nuk jeni të dëshiruar të qëndroni më këtu, – foli Xhafari.

Të gjithë të pranishmit hapen sytë në drejtim të Xhafarit, pos Nuriut që vazhdonte të mbante **kokën ulur, pothuajse midis këmbëve. Sikur pjesëmarrësit nuk po u zënin besë veshëve çfarë dëgjuan.**

– **Përse është kurvë bashkëshortja e nderuar e Kadriut?** – ia drejtoi Mirani Xhafarit, duke ruajtur qetësinë e jashtme, të cilën përbrenda pothuajse e kishte humbur. Sa s'po eksplodonte.

– **Ajo kurvë e dërguar nga UDB-ja** i ka qitur shokët në pritë, – u përgjigj Xhafari, që po ngjante me shumë në një kërmë se sa në njeri.

– **Pa na e zbërthe edhe këtë komplot, se si i keni sajuar detajet!?**

– Nuk jam këtu para UDB-së që të përgjigjem në pyetjet e tua, – tha Xhafari.

– Mor kriminel i dërguar, do të sqarosh apo do të ta dredh qafën si të gjelit!? – e kërcënoi Mirani, i cili po shtrëngohej për t'ia mbërthyer fytyrën. Tashmë Mirani kishte fituar siguri se pos ndërhyrjes për t'i ndarë nuk do t'i hidheshin të tjerët.

– Dihet, – nisi të përgjigjet Xhafari, që kishte humbur davanë, – **Kadriu ka lënë orarin kur do t'i telefonojë kurvës së tij.** Ajo ka informuar vrasësit për orar dhe pastaj vrasësit kanë zënë pritë." (Atentatet, f. 363-364)

Ibrahim Kelmendi: "Sadik, ...Gjithsesi, çdo gjë do nxjerrë koha në dritë, por ti duhet të provosh menjëherë ta përshkruash ngjarjen pastaj të shohim: **ndoshta je i pastër si loti dhe mbetemi shokë të mirë.** Për të ardhur gjer tek kjo, do të ishte dashur një sinqeritet i thellë, duke pranuar edhe ndonjë gabim të vogël nga mosdija..." (Letër për Sadik Blakajn më 21 janar 1981. Marrë nga Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, faqe 407)

Dezertori apo Dordoleci superior i UDB-së Serbe dhe Vëzhguesi i tij superior: "Në këtë pozitë **inferiore** nga ana e „zëvendësit“, ndjehej **edhe** udhëheqësi i FKP-së, Ibrahim Kelmendi." (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, 2010, f. 89)

-11. Mos më keqkuptoni, por kam shkruar sipas qejfit tim

Ibrahim Kelmendi: "Ato (ngjarjet-shën. i Xh. D.) janë paraqitur ashtu siç i kam përjetuar dhe siç i kam mbajtur mend, **pa pretendim për të qenë të vërteta historike.**"(kopertina e mbrapme e romanit Atentatet)..."romanin e kam shkruar sipas qejfit".

Saime Isufi: "...Këtë e bëj, pas leximit të **veprës tënde historike "Atentatet"**, për të cilën të përgëzoj nga zemra! Edhe njëherë urime!

...Për ato rrethana, ku pjesëmarrëse kam qenë edhe vetë, vërtetë secilin personazh e ke paraqitur të tillë siç pata mundësi t'i njihja edhe vetë." (Letër I. Kelmendit, 5 mars 2007, www.pashtriku.org)

I. Kelmendi: Afishuar me: 26.03.2007 15:45 "**Mos më keqkuptoni, por romanin e kam shkruar sipas qejfit** dhe bindjeve të mia. Edhe po t'i dija **qejfin**, bindjet dhe përcaktimin Tuaj, ua them më keqardhje, nuk do ta kisha shkruar sipas tyre." (www.kosova.de)

-12. Keqpërdori ndihmat për Kosovën

Përgjashtimi i Ibrahim Kelmendit prej KQ të LRSSHJ (Komitetit Qendror të Lëvizjes për Republikën Socialiste Shqiptare në Jugosllavi), pos tjerash për keqpërdorimin e ndihmave për Kosovën

"Njoftim

Njoftohen shokët Xhafer Shatri dhe Ibrahim Kelmendi për mbledhjen e fundit të KQ të LRSSHJ

"Duke e parë situatën e krijuar, Xhaferi (Shatri-shën ynë) dha dorëheqje me shkrim.

Derisa shoku Xhafer (Shatri-shën ynë) në punën e tij që bëri e përcollën edhe gabimet, në anën tjetër shoku Ibrahim Kelmendi nuk punoi fare, por u muar drejtpërdrejt me përcjelljen e punëve dhe gabimeve të Xhaferit; u muar me thash e thëna në mesin e punëtorëve. Bëri edhe dekonspirime të sekreteve të KQ të LRSSHJ-së. **Keqpërdori ndihmat për Kosovën**, duke mos sjellur në fond asnjë qindarkë. P.sh. të përmendim vetëm rastin e **Suedisë** në praninë e katër vetave një familje shqiptare i dha ndihmë

I. Kelmendi: "Udhëtova me Hakanin,, alias Plakun dhe Sarandën, alias Bulen. Në Suedi na pritën bujarisht. Fëllanza me bashkëshortin dhe

patriotin e devotshëm, Nexhip Toskën na dhanë **pesëdhjetë mijë korona** suedeze ndihma. Ishte rasti i parë që po na jepej një ndihmë kaq e madhe." (Atentatet, f.391)

luftës sonë prej 50.000 korona, **prej të cilave nuk sollli asnjë qindarkë**, si dhe ndihmat që dhanë familjet e tjera në Suedi; mbjellja e frymës përçarëse në vetë KQ; mospërgjegjësia ndaj punës; prishja me miq zviceranë; mosaktiviteti me të huaj dhe krijimi i ftohjes së tyre ndaj luftës sonë dhe organizatës sonë."

"Kështuqë KQ i LRSSHJ me shumicë votash 4:1 (katër me një) vendosi që shokët Xhafer Shatri dhe Ibrahim Kelmendi përjashtohen nga KQ i LRSSHJ-së, përderisa të mos e vërtetojnë të kundërtën me aktivitetin e tyre.

10 shkurt 1985 Zvicër

KQ i LRSSHJ" (Faridin Tafallari, *Terror Dhimbje Qëndresë, Tiranë 1997*, f.253-254)

Dëshmitare kur Ibrahim Kelmendit i janë dhënë 50 mijë korona suedeze nga Nexhmi e Shefkate Sherolli është Saime Isufi. Anëtare e Komitetit Qendror të LRSSHJ në Zvicër, i cili më 10 shkurt 1985 e përjashton Ibrahim Kelmendin për hajni është Saime Isufi.

Ibrahim Kelmendi: Afishuar me: 23.03.2007 21:18 "Në xhepat e mijë të grisur nuk ka bir nëne (e **as bir kurve**), që do mund të kërkonte të hollat e tij ose të hollat e cilido kontribues, që do të thotë se nuk kam shpërdoruar e përvetësuar nga ato mjete për vete dhe as për familje." (www.kosova.de)

-13. Që të mos flinin me gratë e tyre

Letër publike Zotëriut Peter Feith

(Kjo pikë nuk ka të bëjë me librin *Atentatet*, por e mora se i përshtatet temës që është në shqyrtim)

I. Kelmendi: "Ju lus, sepse jam i bindur, se po që se do u sugjeronit Ju qeveritarëve tanë që të **mos flinin me gratë e tyre**, binduni, ata vërtetë nuk do të flinin, sepse edhe këtë sugjerim Tuajin ata do ta kuptonin si urdhër. Dhe meqë do ta kuptonin si urdhër, ata do frikësoheshin se ju do i hiqni nga postet qeveritare, po nuk ju dëgjuan. E ata i duan postet qeveritare më shumë se gratë e tyre, gjithsesi edhe më shumë se qytetarët e tyre." (Letër publike shefit të ICO-s, Zotëri Peter Feith, 5 shkurt 2009, Botuar në www.pashtriku.org)

-14. Cipërcullakosje

Biseda në forumin www.kosova.de rreth librit *Atentatet*

Moskeqkuptime, qejfe, cipërcullakosje, zhveshje, mveshje, pa pretendime për të qenë të vërteta, fantazi të vitit 2007 dhe jo ngjarje të vitit 1982

"Asgjë më të bukur e më të ëmbël s'ka sesa e vërteta."

I. Kelmendi: Afishuar me: 26.03.2007 15:45 "**Mos më keqkuptoni**, por romanin e kam shkruar sipas **qejfit** dhe bindjeve të mia. Edhe po t'i dija **qejfin**, bindjet dhe përcaktimin Tuaj, ua them më keqardhje, nuk do ta kisha shkruar sipas tyre." (www.kosova.de)

Sali Kabashi: "...duke qenë se në librin e tij e shohim **cipërcullak të zhveshur**... ..edhe mjeranët shqiptarë" (Prill 2007, Republika)

I. Kelmendi: "Edhe për Rezilin ndjej keqardhje,... ..edhe ai do të mund të ishte njeri pa këto gjynahe që i **mvishen** në roman..." (Republika, prill 2007)

I. Kelmendi: "Ato janë paraqitur ashtu siç i kam përjetuar dhe siç i kam mbajtur mend, **pa pretendim për të qenë të vërteta historike.**"(kopertina e mbrapme e romanit *Atentatet*)..."romanin e kam shkruar sipas qejfit".

I. Kelmendi: : Afishuar me: 26.03.2007 15:45 "**Mos më keqkuptoni**, por romanin e kam shkruar **sipas qejfit** dhe bindjeve të mia. Edhe po t'i dija qejfin, bindjet dhe përcaktimin Tuaj, ua them më keqardhje, nuk do ta kisha shkruar sipas tyre." . (www.kosova.de)

I. Kelmendi: "Mendimet dhe vlerësimet **janë të kohës, kur kanë ndodhur ngjarjet.**" (Kopertina e mbrapme e librit *Atentatet*)

I. Kelmendi: I nderuar Z. "panta_rhei" ! (Afishuar me: 25.03.2007 21:11) "Ju keni të drejtë kur mendoni, se romanin *ATENTATET* nuk e ka shkruar **Ibrahim Kelmendi i viteve 1978-1985, por Ibrahim Kelmendi i vitit 2007.** Kapitullin e fundit ia kam dorëzuar redaktuesit (Z. Adem Gashi) në fillim të janarit të këtij viti." (www.kosova.de)

I. Kelmendi: "Këshillë - Të mos lexohet nga adoleshentët (nën moshën 16-vjeçare)"

Sali Kabashi: "...duke qenë se në librin e tij e shohim **cipërcullak të zhveshur...** ...edhe mjeranët shqiptarë"

I. Kelmendi: "Pastaj, po të kisha **kurvërimin si qëllim, a nuk të kam ty këtu më afër?**"

I. Kelmendi: "**Mos më keqkuptoni**, por romanin e kam shkruar sipas qejfit dhe bindjeve të mia. Edhe po t'i dija qejfin, bindjet dhe përcaktimin Tuaj, ua them më keqardhje, nuk do ta kisha shkruar sipas tyre." (www.kosova.de)

I. Kelmendi: Afishuar me: 26.03.2007 15:45 "Ju keni të drejtë kur mendoni, se romanin *ATENTATET* nuk e ka shkruar **Ibrahim Kelmendi i viteve 1978-1985, por Ibrahim Kelmendi i vitit 2007.** Kapitullin e fundit ia kam dorëzuar redaktuesit (Z. Adem Gashi) në fillim të janarit të këtij viti." (www.kosova.de)

-15. Epitete

KOMITETI QENDROR I LRSSHJ " Keqpërdori ndihmat për Kosovën, duke mos sjellur në fond asnjë qindarkë. P.sh. të përmendim vetëm rastin e Suedisë në praninë e katër vetave një familje shqiptare i dha ndihmë luftës sonë prej 50.000 korona, prej të cilave nuk solli asnjë qindarkë, si dhe ndihmat që dhanë familjet e tjera në Suedi." (Vendim i Komitetit Qendror të Lëvizjes për Republikën Socialiste Shqiptare në Jugosllavi për përjashtimin e Ibrahim Kelmendit nga KQ, më 10 shkurt 1985. Marrë nga Faridin Tafallari, *Terror-Dhimbje-Qëndresë*, Tiranë 1997, f.253-254)

I. Kelmendi: "Në xhepat e mijë të grisur nuk ka bir nëne (**e as bir kurve**), që do mund të kërkonte të hollat e tij ose të hollat e cilido kontribues, që do të thotë se nuk kam shpërdoruar e përvetësuar nga ato mjete për vete dhe as për familje." (Afishuar me: 23.03.2007 21:18, www.kosova.de)

-16. Nuk e dinte të mirën, nuk kishte turp

Faridin Tafallari: "*Ibrahimi* (Kelmendi-shën ynë) ka ecur më shumë. Ai ishte i pa disiplinuar, me ca sjellje jo të mira dhe aq më shumë të pa pranueshme tek ne shqiptarët. **Futej në kuzhinë, te gratë...** Shtrihej në dhomë gjerë e gjatë dhe nuk e kishte për gjë, se ishte ti me familje. Ai shtihej sikur të ishte në shtëpinë e vet... **Nuk tregoi asnjëherë mirënjohje për gjitha ato pritje që i bëheshin nga gratë e shokëve** duke e nderuar si një patriot! Prandaj **ai nuk e dinte të mirën, nuk kishte turp.**"(ÇKA PRET IBRAHIM KELMENDI, PSE NUK BËN KALLZIM PENAL NDAJ VRASËSIT TË JUSUF E BARDHOSH GËRVALLËS DHE KADRI ZEKËS (!?!), www.pashtriku.org, 26 qershor 2007)

II

Serbet e maskuara si kroate e boshnjake

Të gjitha citatet e mëposhtme janë nga libri *Atentatet* i Ibrahim Kelmendit.

"– Pyetja e fundit: Përse pothuajse shumica e pjesëtarëve të organizatës suaj i kanë **gratë ose dashnorët serbe**, duke filluar nga Emil Kastrioti, Vehbi Ibrahim, e të tjerë si këta?

– Mendoj se ua kanë dhënë eprorët, për t'i mbajtur më mirë nën kontroll edhe jashtë. Po nga i di ti të gjitha këto, nëse më lejohet të të pyes?

– Të gjithë ata që i njohin, flasin për këtë dukuri, meqë jo të gjithë anëtarët i keni të rekrutuar nga kjo farë UDB-ja serbe. Disa i keni anëtarësuar, meqë i keni mashtruar sa për t'i përdorur për informatorë dhe për t'ua zhvatur ndonjë para në emër të anëtarësisë dhe të kontributit për veprimtari, në dukje patriotike. Ata të shkretë nuk ju njohin, por nuk durohen pa folur, meqë nuk u pëlqen pse i kanë **gratë e dashnorët serbe**.



-Cila është Serbe?, - Cila është boshnjake?, - Cila është kroate? A mundeni me më tregue? -Sepse unë nuk mundem me i dallue!

– Edhe unë nuk ua kam begenisur atyre këtë përçudni. Ti e pe, unë e kam gruan shqiptare, atë që ma ka fejuar baba, sipas traditës." (*Atentatet*, f.81)

"I dëgjova kur dolën së bashku Rezili me atë gruan. Ata flisnin midis tyre **serbisht, mbase kroatisht apo boshnjakisht**, gjuhë që unë nuk i dalloj." f.133

"– Mos më hidhëro, sepse nuk e kam pasur të lehtë taurvej dhe sidomos të përmbahem pa e vrarë në shkallë kur e shihja të bisedonte e të tallej me atë **shkinulë**.

– Atëherë qenka puna thellë. Nuk doka kallauz për të konstatuar se ai është kuadër i UDB-së. Edhe individë të tjerë, për të cilët unë kam formuar bindje se janë udbashë, i kanë gratë serbe. Ata, si nacionalistë e patriotë që reklamohen, për **gratë dhe dashnoret e tyre serbe, gënjejnë se i kanë boshnjake ose kroate**. Meqë qenka kështu, të shkojmë te Jusufi e Bardhi.

– Po shkojmë, – miratoi Vasili." f.133

"– Të shohim nëse vërtet Rezili jeton me atë **gruan**, për të cilën ti po dyshon që është **serbe**." f.134

"Dhoma e gjumit duhej të ishte përballë, por nuk e dinte nëse në atë kohë ishte aty gruaja dhe djali. Ai po mendonte se **serbja** dhe fëmija duhej të ishin në dhomë të gjumit, meqë takimi ishte planifikuar në lokal." f.136

"– Përfashta! – ulëriti Rezili tashmë i tërbuar fare. Nuk të duhet gjë ty, është jetë private kjo!

– Mos ulërit se nuk ta kam frikën. Mos më bëj të të hedh nga dritarja! – ia ktheu Mirani.

– Ti do të duhet të shpjegosh se përse **bashkëjeton me një serbe** në një banesë? Përse e ke mbajtur deri tani këtë të fshehtë ndaj këtyre, nënkryetarit e sekretarit të Grupit? Duhet t'u tregosh këtyre se në çfarë vendi të sigurt, nën përkujdesjen e një **serbeje**, ruake gjithë dokumentacionin e Grupit!

Mirani fliste drejtuar nga Rezili, por po vështrohte herë pas here Maksin, se mos ai bënte ndonjë lëvizje. Tjetri nuk lëvizte vendit, por dukej se ishte shokuar nga shpërthimet e Rezilit, të **bashkëjetesës së tij me serbe**, siç e mori vesh më në fund." f.143

"Rezili iu kishte afruar dritares dhe mbante kokën me të dy duart, duke mërmëritur nëpër dhëmbë, por që nuk kuptohej se ç'thoshte. Ndërkohë Maksi foli me zë të theksuar:

– Vasil, ku po do? Ndal të bisedojmë pse ky qen bashkëjetoka **me një shkinulë** këtu, kurse gruaja ime dhe shokët tanë janë në burg në Kosovë për tradhtinë që na e paska bërë ky pis." f.143-144

"– Çfarë po flisni kështu, ai duhet vrarë, – foli Maksi i përndezur. – I kam dorëzuar në origjinal formularët e anëtarësimit të plotësuar e të nënshkruar në Kosovë, pa ditur se ai jeton në të njëjtën banesë me një **shkinë**, me të cilën paska edhe djalë." (Atentatet, f.145)

III

PREJ NJË SHPATI T'I LËSHOVA SYTË

HEROINAT E STOLISURA DHE FATI I BIZHUTERIVE TE TYRE, APO:

PREJ NJË SHPATI T'I LËSHOVA SYTË

KUR T'I PASH RRUAZAT NË FYT

Të gjitha citatat e këtij nëntitulli janë marrë nga libri Atentatet i Ibrahim Kelmendit

"Në shtëpi të malësorit nga Tetova, e njeh edhe ti Saimir Përcën, po palosnim Bashkimin, për të kursyer që të mos e paguanim shtypshkronjën për këtë. Ishte babai dhe bashkëshortja e Saimirit. Ajo sapo kishte ardhur nga vendlindja. Ishin edhe gjashtë bashkëveprimtarë të tjerë. Në një çast të papritur, bashkëshortja e Saimirit vuri mbi tavolinë **bizhuteritë** e saj duke thënë: "Urdhëroni, shfrytëzoni këto për të financuar daljen sa më të shpeshtë të gazetës. Duhet t'ju vijë keq që nuk po e ndihmoni financiarisht. Mirani po detyrohet të jap të hollat e veta që po i fiton duke shpërndarë natën pamflete e

reklama...”.

Babai i Sajmirit, vjehrrri i saj, i bërtiti: “Nuse, të ka lënë mendja, si po na turpëron kështu!”

Ajo ia ktheu: “Jo baba, por këto m’i keni blerë mua, janë të miat dhe unë po vendos t’i jap për botim të gazetës. Po më vret ndërgjegjja t’i mbaj për vete, sidomos kur po shoh se ju nuk po e kuptoni që duhet të ndihmoni më shumë se sa ndihmat simbolike. Ju dëgjova kur u paraqit raporti i ndihmave që kishit grumbulluar. Më erdhi keq...” “Pusho më!” – e pat ndërprerë vjehrrri.” (Atentatet, f.157)

“Erdha këtu dhe pashë se si shqiptarët po bënë vetëm llafe, po punonin si skllevër për të paluar sa më shumë dollarë dhe i kishte mbërthyer vesi i babëzisë për të hëngër tri herë në ditë steka. Unë nuk po mundem ta duroj këtë gjendje. Ja ku i ke **bizhuteritë** e mia,— foli Mirëvetja në drejtim të Miranit,— sepse nuk po mund t’i mbaj në qafë mbi 100 tonelata miell, kur në Prishtinë vëllezërit e motrat tona që po përzihen nga puna për shkak të pjesëmarrjes në demonstrata nuk kanë bukë të hanë, nuk kanë as armë të vetëmbrohen nga kriminelët serbë.

Vaji me dënësë ia ndërpreu fjalën emocionuese.



Bizhuteritë e shumta

I hoqi **bizhuteritë e shumta** nga qafa dhe i vendosi mbi tavolinë. Iku për të vazhduar vajin gjëmë në dhomën tjetër. Kunatat i shkuan prapa dhe po e lagnin me ujë duke menduar se e kishte humbur vetëdijen kur u përplas në shtrat në dhomën ku rrinte familja me mysafirët. Binaku dhe Mirani mbeten të heshtur pa ditur çfarë të flisnin. Nuk po lëviznin vendit dhe dukeshin në gjendje prej të nemiturve.

Mirani po mendonte me vete: “Hera e pestë që gratë po shfaqin gatishmëri për të

ndihmuar veprimtarinë çlirimtare në mënyrë konkrete. Hera parë me ka ndodhur në vitin 1978, në Düsseldorf. Malësorja nga Tetova, emri i së cilës tani nuk po më kujtohej, por di që është bashkëshortja e bashkëveprimtarit Saimir Përca, kishte ofruar gjithashtu **bizhuteritë** e saja për të financuar botimin më të shpeshtë të gazetës Bashkimi. Ajo tani nuk është në Gjermani, pasi UDB-ja pat arrestuar Saimirin kur shkoi për pushime në Tetovë. Herën e dytë, Fatushi, vajza e veteranit Hysen Kalishta që kishte lindur në kampe të refugjatëve të luftës në Greqi, ishte organizuar në Bruksel bashkë me tri shoqe të saja që t'u trokisin derë më derë shqiptarëve duke u kërkuar atyre ndihma financiare për Kosovën. Gojëkëqijtë ishin përpjekur ta sabotonin këtë aksion duke i përgojuar ato se gjoja po mblidhnin të holla për vete. Herën e tretë, Malësorja e Gostivarit, Hana, me shami të havalesë në kokë, gjatë vitit 1981, mblodhi ndihma simbolike në tubimet e gjermanëve, pasi u kishte folur atyre për gjendjen e rëndë në Kosovë dhe për domosdoshmërinë e çlirimit të Kosovës nga pushtimi serb dhe nga diktatura komuniste. Herën e katërt, Fllanza, bashkëshortja e patriotit veteran Nexhip Pogradeci dhe motra e Enis Mitrovicës, e cila bashkë me të Shoqin dha ndihmë pesëdhjetë mijë korona suedeze kur ishim gjatë vizitës në Suedi në fund të shkurtit të vitit 1982. Tani edhe Mirëvetja po i ofronte **bizhuteritë** e veta në këtë mënyrë kaq demonstrative dhe dramatike. Se mos është kjo dhunti e mendësi,—po rezymonte Mirani,— që ka për bazë ndjeshmërinë më të theksuar të gruas, për dallim nga burrat, meqë nuk kam përjetuar ndonjëherë që burrat, madje as bashkëveprimtarët, të shprehin gatishmëri kaq konkrete dhe kaq me vlerë për të ndihmuar veprimtarinë çlirimtare!?” (Atentatet, f.409-410)

KOMITETI QENDROR I LRSSHJ " Keqpërdori ndihmat për Kosovën, duke mos sjellur në fond asnjë qindarkë. P.sh. të përmendim vetëm rastin e Suedisë në praninë e katër vetave një familje shqiptare i dha ndihmë luftës sonë prej 50.000 korona, prej të cilave **nuk solli asnjë qindarkë**, si dhe ndihmat që dhanë familjet e tjera në Suedi." (Vendim i Komitetit Qendror të Lëvizjes për Republikën Socialiste Shqiptare në Jugosllavi për përjashtimin e Ibrahim Kelmendit nga KQ, më 10 shkurt 1985. Marrë nga Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, f .253-254)

Dëshmitare kur Ibrahim Kelmendit i janë dhënë 50 mijë korona suedeze nga Nexhmi e Shefkate Sherolli është Saime Isufi. Anëtare e Komitetit Qendror të LRSSHJ në Zvicër, i cili më 10 shkurt 1985 e përjashton Ibrahim Kelmendin për hajni është Saime Isufi.


Ibrahim Kelmendi: "Në xhepat e mijë të grisur nuk ka bir nëne (e as bir kurve), që do mund të kërkonte të hollat e tij ose të hollat e cilido kontribues, që do të thotë se **nuk kam shpërdoruar** e përvetësuar nga ato mjete për vete dhe as për familje." (Afishuar me: 23.03.2007 21:18, www.kosova.de)

- Kush janë Nexhmi e Shefkate Sherolli?
- Ata për një kohë kanë qenë vjehrra dhe vjehrra e Hasan Kadriut nga Presheva.
- Se kush është Hasan Kadriu nga Presheva, sipas shokëve të Hasan Kadriut shihet në kapitujt vijues.

ISMET RASHITI

RRËFANË LIRIE

(Veprimtarë të vitit 1981 në Zvicër)



Redaktorë

Xhafer Shatri
Saime Isufi

Korrektor gjuhësor

Avni Dehari

Ballina

Sherif Zenuni
Muhamer Shabani

Pregatitja për shtyp

Skender Hajdari

Botues

“KOMBI” (IKDFK) - Prishtinë

U shtyp në shtypshkronjën

INTERGRAF - Ferizaj

©Copyright 2010, të gjitha të drejtat janë të autorit

*“Bashkimi
kombëtar mbi
të gjitha”!*



Hasan Kadriu

Atdhetari i përkushtuar me tërë fuqinë e tij intelektuale e fizike, Hasan Kadriu, lindi në Preshevë në një familje të njohur atdhetare. Viti historik 1981, studentin e talentuar dhe patriotin e kulluar, Hasan Kadriu, e gjeti në bankat studentore të Universitetit të Friburgut. Ndonëse në moshë të re dhe në një mjedis krejt të panjohur, filloi ta propagandonte, në mesin e studentëve dhe të profesorëve universitarë të Friburgut, çështjen e pazgjidhur shqiptare, sidomos kërkesat e drejta që kishte shtruar për zgjidhje populli i Kosovës në pranverën e vitit 1981.

I edukuar dhe i brumosur nga i ati, Skënder Presheva, burrë, intelektual, patriot dhe luftëtar i denjë për çlirim e bashkim kombëtar dhe nëna e tij, që vinte nga një derë intelektualësh e patriotësh, Hasani që në moshë të re, ishte shquar për atdhedashuri të flaktë, guxim e njohuri të thella të çështjes shqiptare.

I
Ha
org
gju
me
“St
afë
e p
veç
çde
sho
kol
hu
i p
nu
dij
pa
me
qy
Ga
bëj
an
që
në
ba
ma
me
tho
Ha
ng

Demonstratat e para të mërgimtarëve shqiptarë në Zvicër, Hasan Kadriun e gjetën në ballë të tyre, si pjesëmarrës dhe organizator i flaktë. Përkthimi dhe shpërndarja e trakteve në gjuhën frënge, ishte njëra nga detyrat që i merrte dhe i kryente me korrektësinë më të madhe. I njohur me pseudonimin “Studenti i Friburgut”, ishte njëri nga bashkëpunëtorët më të afërt të dëshmorit, Kadri Zeka. Te Kadriu ai kishte gjetur njeriun e përkushtuar, idolin e tij dhe s’do t’i ndahej për asnjë çast në veprimtarinë patriotike e kombëtare. Hasani ishte i gatshëm, në çdo kohë dhe në çdo situatë, t’i gjendej afër Kadri Zekës e ta shoqëronte me makinën e tij ditën e natën, sa herë ta kërkonin koha dhe nevoja. Po ashtu nuk ka tubim, që është mbajtur me të huajt, pa praninë e Hasanit, i cili me përgjegjësinë më të madhe i përkthente ato që i thoshte Kadriu.

Ndonëse, në atë periudhë, ishte njëri nga intelektualët, që numëroheshin në gishta të dorës dhe sado që nuk i mungonte dija e guximi, në asnjë rast dhe për asgjë, kurrë nuk ka vepruar pa u konsultuar me Kadriun, sepse dëshironte që gjithnjë dhe me çdo kusht të bëhej më e mira për Atdheun e dashur.

Me nismën dhe me përpjekjet e mëdha të Hasan Kadriut, qysh në vitin 1981, u themelua klubi i pavarur shqiptar, “Shotë Galica” në Bulle të Friburgut. “Ato që thotë Kadri Zeka duhet t’i bëjmë realitet. Asgjë nuk pritët prej klubeve që mbajnë lidhje me ambasadat e Jugosllavisë. Ata që e ndiejnë veten shqiptarë dhe që duan të kontribuojnë për vendin e tyre, duhet të anëtarësohen në klubin “Shotë Galica”, - propagandonte kudo në meset e bashkatdhetarëve.

Shembullin për themelimin e klubit “Shotë Galica” e kishte marrë nga bashkëveprimtarët në Gjenevë, të cilët pak muaj më parë e kishin themeluar klubin “Igballe Prishtina” për themelimin e të cilit kontribut të madh kishte dhënë edhe Hasan Kadriu. Pothuaj për çdo fundjavë, Hasani udhëtonte nga Friburgu në Gjenevë për të marrë pjesë në organizimin

e manifestimeve të ndryshme e të shumta kombëtare që organizoheshin në Klubin e atjeshëm. Ai më vonë u bë njëri nga bashkëpunëtorët më të ngushtë të udhëheqësit të LRSHJ-së, Xhafer Shatri. Bashkëpunonte me veprimtarët, Zijah Shemsiu, Hasan Mala, Kadri Avdullahu, Shyqeri Ukshini, Ismet Rashiti, Gafurr Çalaj e shumë të tjerë, të cilët gjatë viteve 1981 - 1985 ishin shtylla të organizimit të jetës politike, organizative e kulturore të mërgatës shqiptare në Zvicër.

Janë të shumta tubimet e mbajtura gjatë këtyre viteve të organizuara dhe të udhëhequra nga Hasan Kadriu. Bashkë me një numër të madh veprimtarësh nga Friburgu dhe Bulle merrte pjesë edhe në tubimet qendrore e në demonstratat që organizoheshin në Zvicër dhe në shtetet e tjera të Evropës Perëndimore. Gjatë tërë vitit 1981 e deri në momentet e fundit të jetës, ishte e pamundur të organizohej diçka për çështjen kombëtare e të mos ishte i pranishëm Hasani. Atë e gjeje në Gjenevë, në Bernë, në Cyrih, në Lozanë, në St. Gallen, në Bazel, në Dyseldorf, në Shtutgart, në Paris, në Bruksel, në Vjenë, në Tiranë e kudo tjetër; gjithnjë në shërbim të çështjes kombëtare.

Falë talentit dhe bashkëpunimit të frytshëm me intelektualë e me institucione të shumta zvicerane, Hasan Kadriu kishte arritur të zinte shumë miq zviceranë dhe të ndikonte në shumë institucione, nëpërmjet të të cilave e ka ndihmuar shumë çështjen shqiptare dhe afirmimin e vlerave kulturore e sportive. Ishte i pari dhe i vetmi shqiptar menaxher i FIF-as. Nga ky pozicion kishte kontribuar jashtëzakonisht për ta ndërkombëtarizuar çështjen shqiptare në përgjithësi dhe sportin shqiptar në veçanti. Si bashkëveprimtar i dëshmorit Kadri Zeka, e kishte përjetuar tepër rëndë rënien e tij dhe të vëllezërve Gërvalla, më 17 janar 1982 në Untergruppenbah. Ishte ndër të parët që arriti në vendin e ngjarjes. Me shumë veprimtarë të tjerë mori pjesë edhe në varrimin e tyre. I edukuar nga mësimet e tyre dhe i frymëzuar nga vepra e tyre, përpiqej këtë humbje ta kthente në forcë, për



Fot

të
dë
pa
vd
,
gji
që
sa
të
të



Foto e demonstratës së parë të 11 prillit 1981 në Bern të Zvicrës

të punuar edhe më shumë për çështjen kombëtare. Për këtë dëshmi është puna e tij, deri në momentet e fundit të jetës, kur papritmas, më 17 shkurt 1998, në prag të çlirimit të Kosovës, vdiq në një fatkeqësi komunikacioni, në Bullgari.

Guximi intelektual e njerëzor për ta thënë dhe për ta mbrojtur gjithnjë të vërtetën, pavarësisht kostos; dashuria e madhe që ushqente për popullin dhe vendin e tij; shpirti human e i sakrificës që e karakterizonte, do të jetojnë për jetë e mot dhe do të përcillen si shembull brez pas brezi deri në realizimin e Idealit të Tij që përmbledhej në moton: Një Komb, një Shtet, një Vizion!

7. HASAN KADRIU I PRESHEVËS DHE FITIMTARI I 50 MIJË KORONAVE

Ibrahim Kelmendi: "Uroj, që kur të krijohet distanca e bollshme kohore, të bëhen vlerësime kritike, edhe pse thuhet se "historinë e shkruajnë fitimtarët". (Bedri Islami, Lëvizja, Tetovë, 2012, faqe 13)

Më 15 janar 1983 në Ludwigsburg afër Shtutgartit u formua Qendra Ekzekutive (QE) e Lëvizjes për Republikë, e përbërë nga Faridin Tafallari, Hasan Mala, Ibrahim Kelmendi, Xhafer Shatri dhe Xhafer Durmishi. Letra e mëposhtme është një letër e Ibrahim Kelmendit dërguar Qendrës Ekzekutive më 14 prill 1983.

* * *

Të dashur shokë, Një mërgim..., më 14 prill 1983
(dedikuar rastit – shoqes Fitore e Hasanit) (Hasan Kadriut-shën ynë)

Pasi më rastisi të jem në valët e një problemi tejet serioz e shoh të domosdoshme të shkruaj. Dhe, siç do bindemi, na duhet t'i përkushtohemi që të gjejmë zgjidhje të shpejt.

Thuaja se çdo gjë ka marrë kahjen e vet dhe as që ka mundësi të ndërhyrë, bile as që është e arsyeshme të ndërhyrë për të imponuar ndonjë zgjidhje, pos zgjedhjes që do të gjejmë vet të goditurit.

Pasi që kemi të bëjmë me një rast shumë të ndjeshëm, duhet t'i përkushtohemi kronologjisë së tij, për të parë se si qe diç e tillë e mundshme.

Pjesë e luftës sonë është edhe vazhdimësia për të krijuar familje të reja. Kështu, të bazuar në këtë domosdoshmëri, ca prej ne shokëve ndërhyrë, ose përkatësisht ndërmjetësuar që fatin e tyre bashkëshortor ta lidhin shoqja Fitore me shokun Hasan. U gëzuam shumë të gjithë ne që dëgjuam dhe i njofim. Sipas të gjitha gjasave, bazuar në rrymimin e ngjarjeve në këto çaste, bashkëshortësia e këtyre të rinjve mori fund. Pasi isha në korent të ngjarjeve, jo vetëm ditëve të fundit, por që në embrion, kur lindi ideja që këta të rinj të bashkohen, dua të them me bindje se fajin, bile të turpshëm e mban shoku Hasan.

Si rrjedhën ngjarjet?

Aktivitetet patriotike na sollën gjer atje sa të njifemi me familjen e Fitores. Nuk e fshehim, që kur kontaktua dhe u njohëm, ndiem krenari se njofëm familje të ndershme e patriotike. Kjo familje kishte rritur e edukuar Fitoren, me të gjitha virtytet e një vajze shqiptare, por të një shqiptareje revolucionare. Më vonë fitova bindjen, pasi u njohëm edhe më mirë, se Fitorja është yll në lindje, e cila pos që është e ndershme, premtan të bëhet revolucionare e shquar. Më gjatë edhe nuk është e nevojshme të zgjatemi mbi cilësitë e shoqes Fitore, pasi ata që e njofin dhe do ta njofin, do thonë se, shoqja Fitore, e rritur jashtë atdheut, e arsimuar në shkollë të huaja, është për çdo lavdatë. Kurse zellshmëria e saj në studime (drejtësi e anglisht), zotërimi i shkëlqyer i gjuhëve të huaja, shpirti i saj politik e ngritja e saj marksiste, janë dukuri që garantojnë se kjo shoqe do të bëhet një revolucionare e shquar, sigurisht edhe një militante e luftës së popullit tonë të drejtë.

Mbi jetën e veprimtarinë e shokut Hasan nuk kam nevojë unë të shkruaj. Ai duhet ta bënë këtë vet. Por, nuk ekziston as më i vogli dyshim, se që kur shpërthyen demonstratat në Kosovë (që nga demonstrata e parë në Perëndim, nëse nuk gabohem), ishte aktiv në punët patriotike-revolucionare. Të kaluarën dikur nuk ia njihja, por këndej, që kur e njoha, bashkëjetonte me një zvicrane (si duket e pasur...).

Çysh në vizitën e parë prindërit hapën zemrën, pasi që na njifnin që më parë dhe kishin besim të plotë të radhët patriotike. Kështu, pos bisedave për çështje kombëtare, u bisedu edhe për halle të të familjes, pa rezerva.

Të shtyrë nga rrethanat, sidomos ato të quajtura kurbet, e biseduan edhe çështjen e vajzës, se si janë të dëshiruar, pasi ka mbushur vitet, t'i gjejnë një shok, por të ndershëm e patriot. Vajza atëherë ishte maturante në gjimnaz dhe po e kryente me sukses të shembullor. Unë, siç i kujtohet më shumë shokëve se mua, kisha këshilluar prindin e Fitores që të mos nxitohen dhe ajo duhet të vazhdoj në studime, e ndërkohë ka për të gjetur shok nga ata që njofim ne.

Kur u ktheva m'u dha rasti të takoj shokun Hasan. Biseduam, pos tjerash, se kisha njohur një familje të ndershme dhe revolucionare. Ai u gëzua. Biseduam se si në të ardhmen do t'ua krijojmë mundësinë të njifeni dhe po u pëlqyet, të martoheni.

Në ndërkohë prindi i Fitores u njoh me Hasanin. Hasani i la përshtypje të mirë, pasi asaj radhe na ra të rrugëtojmë bashkarisht më gjatë. Kur duheshin të ndahen, prindi i Fitores, përndryshe shok aktiv, muar telefonin nga Hasani. Unë ia bëra me dije, tërthorazi se në telefon lajmërohet një grua, me të cilën Hasani po bashkjeton. Hasani më qortoi pse tregova dhe u arsyetua se te ajo vetëm banon. Me prindin udhëtuam, Hasani mbeti. Biseduam disa herë mbi Hasanin, pasi prindi kishte formuar përshtypje të mirë.

Për më shumë se katër muaj qesh larguar. Por shoku Hasan me familjen e Fitores kishte vazhduar kontaktet, kryesisht përmes bisedave telefonike. Me kalimin e kohës ishin njoftuar e afruar aq shumë, sa shoku Hasan e paskësh parë të rrugës t'i angazhoi shokët që të ndërmjetësojnë.

Në demonstratë të Gjenevës u takuam prap. Kësaj radhe në demonstratë kishte ardhur edhe Fitorja. Kur e pashë në radhë, gati sa nuk qirrej së thirruri parolla, bashk me motrat që kishte përkrahu. Thash me vete, nuk qenka vetëm e zellshme në mësim dhe e ndershme, por qenka taman revolucionare. Po e them këtë me qëllim, pasi nuk është gjithaq e rëndomtë që vajzat e rritura dhe shkolluara në Perëndim të kenë edhe revolucionaritet të këtillë.

Shoku Hasan kishte ngarkuar dy shokë, Ujkanin dhe Bacën që të ndërmjetësojnë. Për mrekulli. Bisedojnë dhe arrihet mirëkuptimi. Por, siç po thuhet tani, prindi na qenkësh informuar se Hasani bashkjetonte me një zvicerane. Shoku Hasan kishte siguruar shokët se bashkjetesa kishte marrë fund, pasi nuk po mirëkuptoheshin, ose siç shprehej edhe shoku Hasan, ishin prishë. Kështu edhe Ujkani edhe Baca i kishin thënë prindit se më nuk po bashketojnë. Prindi dhe Fitorja kishin dakorduar që "t'i vënë vizë" (siç shprehen tani) bashkjetesës me zvicerane. Por, sigurisht, kusht i vetkuptueshëm: të mos bashketojnë më!

Se si u zhvilluan ceremonitë e fejesës, nuk na hynë në punë. Të gjithë uronim.

Në një mbrëmje, në prag të Vitit të Ri, ku ishin të pranishëm edhe shokë të tjerë, Hasani se si u hap dhe tregoi për aventurat e tija degjeneruese në të kaluarën, që në vitet e hershme të rinisë. Them të vërtetën u dëshprova. Sidomos edhe mënyra e tregimit, në formë krenarie, dhe fakti se disave nuk u bënë përshtypje shumë. Shkurt: shihej se çfarë pasojash kishim nga robëria jugosllave, ku mbretëron një sistem taman i degjeneruar, sa i përket moralit. Edhe më parë, në trojet tona, ishte përhapur si epidemi "krenaria" për t'u marrë me aventura degjeneruese, duke u shprehur se "duhet të jetohet rinia...". Kur Hasani hetoi se te unë "krenaria" e tij mbi aventura degjeneruese po lenë përshtypje shumë të keqe, e pau të rrugës t'më kërcnohet: "Po më qarte punë te familja e Fitores do të shofish se kush jam unë...", diçka në këtë drejtim bëheshin kërcnimet. Unë i thash: "... punë nuk do të qarti, por ta dish se qëndroj prapa Fitores si prapa motre e shoqes së idealit po që se do të tradhtohet..."

Kisha dëgjuar edhe të tjerët tek flisnin mbi aventurat e tyre degjeneruese, por aventurat degjeneruese të Hasanit ua kalonin filmave amerikan, apo ndoshta ilustronte pasi "krenaria" e shtynte. Sa m'u thy vullneti. Disi me Hasani isha afruar shumë, pasi ishte aktiv në veprimtarinë tonë. E vërtetë është se dija për bashkjetesën me zvicrane dhe për shpirtin e tij aventurier. Por edhe këtë shumë e arsyetonin, kryesisht vetë Hasani, se kushtet e kanë detyruar të bashkjetoi...

Pas fejesës u bë kurorëzimi, më shumë për çështje të rregullimit të lejes së qëndrimit. Por, menjëherë pasi lidhën kuror, përkundër vullnetit të prindërve (Fitorja thua se ngjan në figurë shahu, pa u tregu gjithaq aktive kur vendoset diç), Hasani insiston me këmbëngulje të njëmendët, pa i patur as kushtet ta marrë Fitoren, mbi të cilën tash e tutje na paskësh pushtet, pasi e ka grua... dhe të shkojnë në Zvicër. Atje ata kanë fjetur së bashku disa ditë. Gjatë atyre ditëve, siç tregon Fitorja dhe siç e pranoi edhe Hasani, Hasani po me krenari (ndoshta jo – por kështu tregon Fitorja) i ka folur mbi aventurat në të kaluarën, se si ua paska marrë qikninë disa vajzave shqiptare..., etj. (siç na kishte treguar edhe ne më parë.). Shkurt, Fitorja tregoi aq shumë gjëra, sa po të ketë treguar të vërtetën (e unë po i besoj tërësisht), Hasani ose nuk duhet të ketë qenë në vete, ose e ka bërë me qëllim që ta largoi Fitoren. (Për fjalët që ka folur Hasani, po u desh, do të shkruhet veçmas.) Nga e gjitha konkludoi se Hasani dinjitetin e Fitores e kishte cënuar dhe marrë nëpër këmbë.

Në mes të tjerave, biseda në mes tyre është bërë edhe mbi bashkjetesën e Hasanit me zvicranen. Fitorja ka dyshuar nga fakti se kudo që e ka dërguar Hasani, ajo nuk ia ka parë asnjë plaçkë. Hasani i qenkësh betuar se nuk po bashkjeton.

Fitorja është kthyer vetëm. Kur ka ardhur në shtëpi i ka treguar nënës mbi të gjitha. I ka thënë, pos tjerave, "... u qudita mami, se si nuk kërceva nga treni gjatë rrugës..."

Pa ditur asgjë, mua më nxjerri nevoja këndeje. Erdha edhe te familja e Fitores. Në mbrëmje nga nëna e Fitores bëheshin shaka, por nuk ishin si të mëparmet, më shumë ishin demaskuese kundra Hasanit. Disa herë reagoval mjaft ashpër, pasi nuk më vinte mirë të sulmohej Hasani, sado që në formë shakash. Bile edhe shoku që ishte me mue e pau të arsyeshme të ndërhy për ta mbrojtur Hasanin. Por ne nuk dinim se çfarë kish ndodhur. Vërehej se diç nuk është në rregull. Të nesërmen mësova të gjitha, por thua se u ngreh gjama si në raste vdekjeje.

U gëzuan që isha aty dhe kishin kujt t'i qahen. Me bindje thanë se Hasani është te zvicranja. Ishte e diel në mbrëmje, vonë. Nuk u besoja se Hasani është te zvicranja, tani kur të gjithë shokët kishin siguruar se nuk bashketojnë më. Vendosa të telefonoj. M'u lajmërua zvicranja. E pyeta se a ishte Hasani aty. Më tha jo. E pyeta se a do vij më vonë. M'u përgjegj se nuk e dinte, bile më tha ndoshta. Atëherë ia lash porosinë të telefononte, pasi kisha diç me rëndësi. Brenda një kohe shumë të shkurtër kishte telefonuar ku ia kisha lënë porosinë. Ishte kjo provë e luhatshme se ishte aty.

Fitorja sikur nuk besonte se Hasani ka shkuar te zvicranja, pasi i është betuar (siç thot ajo, kurse Hasani në bisedën telefonike që pata sot me të, nuk pranoi se i qenka betuar.). Vendosin të provojnë që heret në mëngjez të telefonojnë, por pasi dinin se nuk do t'u përgjigjej, kishin menduar sikur thirrja i shkonte nga Jugosllavia. Ai ishte lajmëruar. Ka qenë rreth orës 6.00 të mëngjezit, të hënën. Ishte provë e pakundërshtueshme.

Kur u zgjova më vonë më treguan. Vendosa të telefonoj. Telefoni u hap, por nuk fliste askush. Unë i thirra dhe i tregova se kush jam, telefoni m'u mbyll. Ishte provë e fortë se qe ai, Hasani, por nuk më lajmërohej, pasi do i bërtisja. I telefonova shokut Ujkan dhe i tregova mbi të gjitha. U befasu. I thash të telefononte ai dhe ta pyeste e të bisedonte mbi ato që kishin ndodhur, se çfarë e si kishte ndodhur. Më vonë, rreth orës 10.00 më

telefonoi Hasani mu, pasi, siç duket, e kishte kuptuar se isha këtu. Kur i tregova se ç'kishte ndodhur dhe pyeta se përse ma mbylli telefonin, më tha se nuk ka qenë aty fare. I thash se edhe mu po më gënjen, pasi ke qenë aty. Kur i tregova mbi telefonin "allo Jugosllavia...", që ia kishin bërë heret në mëngjez Fitorja me nënën dhe ai ishte lajmëruar, atëherë e pranoi. Por pse nuk m'u kishte përgjegj mu, u arsyetu se do t'u tregoja unë Fitores dhe prindërve, bile shprehu dyshimin se do t'ua mbaja anën.

Me prova të thjeshta u vërtetua se ishte aty, por arsyetohej se priste thirrje telefonike...

E këshillova se duhej të merrte kontakt me shokët, që të ndërmjetësojmë, pasi unë isha këtu dhe ata do më tregojnë çfarë duhet të bëjë unë. U telefonuam prap me shokë. U tregova se ngjarjet kanë marrë kahjet e tyre dhe se prindërit bashkë me Fitoren duan ta prishin kurorën, pasi "ultësist ishin tradhëtuar", siç shprehen ata. Më së shumti i trondiste fakti se e gjitha bëhej nga një shok i radhëve të Lëvizjes.

Pasi edhe sot më telefonoj Hasani, u qartësuan punët, por në të keq. Ai kërkoi që unë t'u them se ai kishte për të kërkuar llogari, nga se prindërit e Fitores e paskeshin alarmuar gjendjen, i paskeshin kurdisur thirrje telefonike "alo Jugosllavia...", e paskeshin përzier Lëvizjen, etj. U hidhërova. Foli edhe gjëra tjera të ulëta. Kur i thash se do t'i shkonte letër nga gjyqi për ta nënshkruar se është i pajtimit të prishin kuror, më tha se nuk do ta bënte pa u marrë vesh. I thash se nuk guzon të përdorë shantazhe e gjëra të ulëta më, por duhet të reflekton si shok, pasi për diç të kësaj natyre duhet dhënë llogari. Sa për alarmim e informova se vetëm ne që duheshim ta dinim, e dimë. Kurse se qenka problem thjesht familjar, që s'paska të bëjë fare me Lëvizjen, i thash se nuk është ashtu. "Për gjëra të tilla ka drejtë dhe duhet të interesohet Lëvizja, përderisa ti militon në radhët e saj..."

I tregova shoqes Fitore për bisedën telefonike. I thash se duhet të merr qëndrim që e gjykon vet, pa ta imponuar Lëvizja. Ajo disa herë kishte thënë se po të thotë Lëvizja se duhet të sakrifikoj jetën dhe duhet gjithsesi të bashkëjetoj me Hasanin, pasi ndarja do t'i sillte dame, do ta bënte për hirë të sajë. Unë i thash se duhej të vendoste vetë, pavarësisht, duke patur parasysh se vetëm bashkjetesa e mirëkuptimt është e arsyeshme.

Definitivisht janë dakorduar se duhet të ndahen. Nuk kundërshtova dhe as që e pash të arsyeshme. Arsyetoheshin se Hasanit as që po i intereson mbi asgjë, përndryshe do t'ua tregonte shokëve të vërtetën dhe do pranonte gabimet, duke bërë autokritikë dhe duke na bindur se vërtetë është për bashkjetesë të sigurtë dhe të mirëkuptimt.

* * *

Shokë,

e shoh të arsyeshme t'i ndaj edhe ca mendime konkrete e propozime.

Së pari, pasi gjendemi ku gjendemi, propozoj që të formohet një këshill i zgjedhur dhe ta gjykoj këtë rast. Ne pushtet popullor nuk kemi, prandaj kur raste të tilla ndodhin në radhët tona, ose edhe në popull që i shkon prapa Lëvizjes, duhet të intervenojmë dhe duhet ndarë drejtësinë, sipas kritereve morale të radhëve tona (siç shkruan shoqja Fitore në letrën që shkroi për shokët e radhëve të Lëvizjes.).

Deri sa normat morale nuk i kemi kodifikuar, mendoj se duhet të vlejnjë normat e vetëkuptueshme morale popullore, por jo të kanunit të Lekës. Si parimore është që në çdo aspekt burri i gruaja të trajtohen të barabartë. Poashtu edhe degjenerimi moral i burrit të vlerësohet barabar me degjenerimin moral të gruas, e jo siç ndodh padrejtësisht (siç duan të na e imponojnë të degjeneruarit...), se degjenerimi i burrit mund të arsyetohet "pasi është burr", kurse vetëm i gruas na qenka i dënueshëm... Pra, as një lëshim nga normat morale shqiptare e proletare nuk duhet bërë!

Pastaj, duhet vlerësohet për shkelje të parimeve nëse të degjeneruarit, që nuk janë në gjendje të kontrollojnë veten, vihen në krye të aktiviteteve patriotiko-revolucionare.

Jam rigorozisht e vendosmërisht kundër çdo lëshimi në këtë drejtim, i cili na kompromiton Lëvizjen!

Ne dikur detyruam bashkatdhetarët që të mos e marrin nëpër gojë shokun Hasan për faktin se bashkëjetonte me zvicrane dhe se ajo e mbante, bile edhe i blente kerre sport... Sigurisht që ai u aktivizua shumë, pikërisht edhe pse ju krijuan mundësitë nga bashkjetesa me zvicranen, por sa do t'i arsyetojmë. Në atë drejtim askush nuk mban përgjegjësi më shumë se unë, edhe pse e afrova me bindje se do të ndahej nga ajo, pa ditur për aventurat degjeneruese të mëparme, të cilat, po të vlerësohen në mënyrë kritike vetëm sa tregojnë me "krenari" ai vetë, atëherë mund të konkludohet se ka qenë vijë. Sikur mbi të gjitha të dijë një rreth më i gjerë i bashkatdhetarëve, çfarë ndodhë? Me siguri që do marrin radhët tona në bisht të lahutës. E kush do t'u përgjigjet thirrjeve, po të ndodhte që Lëvizja të kompromitohej me gjëra të tilla? Shoku Hasan pat shansën të rehabilitohej, po t'u vente shqelmin aventurave degjeneruese. Por jo. Ai edhe atëherë kur thonte se është prishur me zvicranen, flinte me te. Në rastin konkret të Fitores, po provon të arsyeton se gjoja ka pritur thirrje telefonike. Por thirrja telefonike nuk pritet vazhdimisht dhe tërë natën. Pastaj, sikur të vendoste se me atë grua do bashkëjetonte nga se e dashuron ose se donte ta marton, do ta arsyetonim disi. Por jo, ai vet ka thënë se nuk do të jeton, vetëm se është duke e shfrytëzuar. Sigurisht që edhe kjo është e dënueshme. Pastaj martoi vajzë shqiptare, ia muar qikninë, dhe prap vazhdoi të shkon te zvicranja. Pa më të voglin lëshim se është e dënueshme. Sikur të vinin në konkludim më parë, kur ishin vetëm të fejuar, se nuk ka kuptim të bashkëjetohej dhe razieshëm të ndaheshin, do të duhej të kërkonim llogari më pak. Por edhe atëherë do të ishte e patolerueshme: T'i lut shokët që të ndërmjetësojnë, dihet cilët shokë, duke i siguruar se nuk po bashkëjeton me zvicrane (pra duke keqpërdorur besimin që kanë patur shokët tek ai...), dhe pasi t'ia marrësh qikninë dhe dinjiteti njerëzor t'i merret nëpër këmbë motrës sonë të bashkëjetoi me zvicranen vërtetë është e dënueshme. Bile, kur t'i shtohen kësaj edhe intrigat që bënë tani, "mos vet", do të thoshte populli.

Mund që kam ardhur në përfundime të gabueshme, por nuk kam patur rast të dëgjoj çfarë do të thoshte mbi të gjitha, por dua të them se mjaftojnë ato që m'i tha në telefon Kazanova (siç i ka thënë Hasani Fitores se është...!!)

Rrethana në përgjithësi janë ngarkuese, po të marrim relacionin e Fitores. Ajo është rritur në kurbet. Prindërit me fanatizëm ia kanë dhënë patriotizmin. Për te shqiptari ka qenë vlerë e madhe. Dhe ja prova e parë serioze... Mue personalisht më goditi përmbajtja e letrës, sa e thuket, aq kuptimplote dhe mendime të peshuara, taman nga pozitat revolucionare. Dhe po të provoi Hasani të ia hjedh fajin Fitores, atëherë le ta di se ka gabuar rëndë... Për as më të voglën aventurë degjeneruese të Fitores nuk mund të flitet, kurse për të Hasanit, mjafton ato që i tregojnë ai vet.

Po sikur të ndodhte që nga kjo tradhëti (siç po vlerësohet këtu) të demoralizohej në ato përmasa sa t'ia kthente shpinën shqiptarizmit... Por, është aq e formueme dhe aq e dhënë pas çështjes kombëtare, sa edhe në këtë gjendje pyet se mos është duke damtuar Lëvizjen.

Mund të duket se u zgjata dhe kam bërë gjykime radikale e të njëanshme, por të shohim si do të jetë edhe mendimi juaj. Deri në çastin kur mësova se në çfarë përmasash është shkelur dinjiteti i Motrës sonë, sikur do t'i bënte ndokush tjetër ndonjë sulm Hasanit, do të duhej t'i llogariste dy Hasana. Tani, kur mësova mbi të gjitha dhe kur zura t'i analizojë në mënyrë kritike aventurat e tij, e ndjeva veten se nuk mbajtur qëndrim parimor që me kohë, për ta demaskuar ashpërsisht çdo aventurë.

Hasani ka të vetmen rrethanë lehtësuese: se degjenerimi i tij fillon në vitet e hershme të rinisë, çka do të thotë se i është imponuar nga shoqëria jugosllave, e qelbur. Kështu, nën këtë variant do të shihej deri diku degjenerimi gjërë në shpërthimin e

demonstratave, por pastaj, kur edhe vetë ju përkushtu aktivitetëve revolucionare, nuk ka arsyetime, edhe pse një dorë e caktuar gjejnë mënyra arsyetuese, gjoja të vështirësive që u lindkan vetëm disave në kurbet. Edhe kundër kësaj forme të degjenerimit atje ku mund të ndikojmë, duhet t'i kundërvihemi duke e demaskuar, pse gradualisht përhapet kjo epidemi...

Në biseda telefonike ka ndodhur të thuhet, sidomos shoku Ujkan, se Hasani ka qenë aktiv, i ka kryer të gjitha detyrat. Kjo është e vërtetë. Por nuk dyshoj se është thënë diç e tillë që të arsyetohet degjenerimi i shokut, ose marria e tanishme.

Përfundimisht, kësaj radhe, nuk po e zgjat më. Gjërave të kësaj natyre duhet t'u përkushtohemi, që më vonë të mos na e haj në dorë qeni shkopin, siç do thoshte populli. Shoku (Ibrahim Kelmendi)

8. Hajduku i Preshevës, amaneti i Hasan Kadriut!

*Ibrahim Kelmendi: "Udhëtova me Hakanin,, alias Plakun dhe Sarandën, alias Bulen. Në Suedi na pritën bujarisht. Fëllanza me bashkëshortin dhe patriotin e devotshëm, Nexhip Toskën na dhanë **pesëdhjetë mijë korona** suedeze ndihma. Ishte rasti i parë që po na jepej një ndihmë kaq e madhe." (Atentatet, f.391)*

(<http://www.sportishqiptar.com.al/newsite/2010/08/31/hajduku-i-presheves-amaneti-i-hasan-kadriut/>)

Reportazh mbi klubin shqiptar të Luginës së Preshevës, i vetmi që garon në ligat serbe të futbollit

Nga Presheva, Valon ARIFI 31 gusht 2010

Gusht 2010, Preshevë: Sa herë të shkon mendja për futbollin shqiptar, s'do mend se aty thërritet edhe emri i të madhit Hasan Kadriu, menaxherit të parë shqiptar pranë UEFA-s dhe FIFA-s. Njeriut që e bëri Igli Taren të madh, por edhe shumë "Tare" të tjerë. Ishte ky Hasan Kadriu, nga Presheva, i cili, si shumë të tjerë, u dëbua nga pushteti serb, për të marrë rrugën drejt Shqipërisë, që aq shumë e deshte.

Nën tingujt e të madhes Vaçe Zela "Për ty atdhe, më të bukurën këngë, me fuqinë e kësaj zemre këndoj...", Kadriu u la amanet bashkëvendasve të tij klubin e futbollit, Hajdukun e madh. Hajdukun, që Kadriu e ndiente kudo që shkonte. Çdo qytet, që ka një histori, mundohet ta ruajë dhe ta kultivojë atë, por kur jeton i okupuar, historia të merret nëpër këmbë dhe të mohohet.

Por jo, Presheva e Hasan Kadriut me nostalgji kujton dhe ruan historinë, traditën dhe talentin për futbollin, si dhunti të falur nga zoti. Presheva, ndoshta në këtë segment nuk ka pasur ndonjë të arritur të veçantë, në përmasa të mëdha kolektive, por Presheva, sot dhe për tërë ekzistencën e vet, mburret me klubin futbollistik "Hajduku", klub ky që për nga mosha është po aq "plak", sa edhe Hajduku i Splitit, themeluar në shtator të vitit 1937.

Hajduku i Preshevës është emër i njohur për futbolldashësit e gjithë rajonit, historia dhe organizimi i tij ka bërë që përballjes me të ti druhet çdo ekip serb. Emra të mëdhej të futbollit, hapat e parë të karrierës i filluan mu në stadiumin e qytetit të Preshevës. Ishte Hasan Kadriu i madh, ishte Fadil Vokrri, që tundte rrjetat e kundërshtarëve, Prekazi e shumë të tjerë, pjesë e sukseseve, që kujtohen nga qytetarët dhe ish-futbollistët preshevarë.

Sot mburrja e qytetarëve të Preshevës, e vetë klubit, është Atdhe Nuhui i Rapidit të Vjenës. "Ibrahimoviçi preshevar", para se t'i shënonte Aston Vilës, qëllonte këndet e portave preshevare. Historikun e futbollit në Luginën e Preshevës e bëjnë edhe më të

bujshëm emrat e mëdhej të futbollit kroat, si Davor Shuker, Alen Boksiç dhe Prosinečki, të cilët, si gjimnazistë të ish-Jugosllavisë, zbuluan talentin e tyre në stadiumin e qytetit të Preshevës.

Musa Musahu, Enver Sahiti, janë disa nga emrat, që me çdo kusht i kërkonte Partizani i Beogradit. Por gjendja e vështirë e viteve 90-të bëri që klubi të stopojë aktivitetin e tij, për të rifilluar në shtator të vitit 2007, ku qysh në ndeshjet e para të ligës së rrethit të Nishit, pati sukses të dallueshëm. Për më pak se një vit, Hajduku rikthehet në zemrat e preshevarëve, ndërkohë që futbollistët e dalluar, Sunaj Musliu dhe Rinor Kamberi kthehen në idhuj të shumë të rinjve të qytetit.

Ndërsa K.F. Hajduk, sot garon në Ligën e 4-t të Serbisë, ku erdhi stinorin e kaluar, dhe qysh në sezonin e parë u rendit e treta në tabelën e klasifikimit. Seancat përgaditore të klubit kanë filluar, rekuizitat dhe fanellat zyrtare për sezonin 2010-2011 janë promovuar, ndërsa pritet ndeshja e parë e klubit, ku mbi të gjitha nuk mungon optimizmi i lojtarëve se ky klub, vitin e ardhshëm do të renditet i pari në tabelë, për të vazhduar pastaj në Ligën e Tretë Serbe.

Klubi sot zyrtarisht numëron 30 lojtarë, ndër ta edhe talentë të moshës 16-vjeçare, të cilët gjatë çdo afati kalimtar marrin oferta të ndryshme nga klubet serbe. Por talentët preshevarë nuk e tradhetojnë amanetin e Kadriut, “se nuk ka klub serb për lojtarët shqiptarë” dhe “shqiptari vishet kuqezi.” Tani, në pankinën e Hajdukut, gjithçka është gati, njëherit “Sporti Shqiptar” do të ndjekë nga afër çdo ndeshje të klubit, veçmas për të promovuar vlerat e talentëve preshevarë, mbase për të realizuar amanetin dhe ëndrrën e Hasan Kadriut, “Presheva në kombëtaren kuqezi”. (sportishqiptar.com, 31 gusht 2010)

KOMITETI QENDROR I LRSSHJ " Keqpërdori ndihmat për Kosovën, duke mos sjellur në fond asnjë qindarkë. P.sh. të përmendim vetëm rastin e Suedisë në praninë e katër vetave një familje shqiptare i dha ndihmë luftës sonë prej 50.000 korona, prej të cilave nuk sollli asnjë qindarkë, si dhe ndihmat që dhanë familjet e tjera në Suedi." (Vendim i Komitetit Qendror të Lëvizjes për Republikën Socialiste Shqiptare në Jugosllavi për përjashtimin e Ibrahim Kelmendit nga KQ, më 10 shkurt 1985; Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, f aqe 253-254)

Ibrahim Kelmendi: "Në xhepat e mijë të grisur nuk ka bir nëne (e as bir kurve), që do mund të kërkonte të hollat e tij ose të hollat e cilido kontribues, që do të thotë se nuk kam shpërdoruar e përvetësuar nga ato mjete për vete dhe as për familje." (Afishuar me: 23.03.2007 21:18, www.kosova.de)

Libra nga Xhafer Durmishi – Skenderi i Shtutgartit, për Rilindasit e Shtutgartit

01. Protesta e Aspirata – Tetor 2006
02. Lëvizja e Jusuf Gërvallës- Tetor 2011
03. Zëri i popullit dhe Zëri i Jusuf Gërvallës-Nëntor 2011
04. Të fala s'po na çojnë asnjëherë-Dhjetor 2011
05. Nuk pyesin për çmimin e lirisë-Mars 2012
06. Pa taktizime-Prill 2012
07. Në rrethin e Shtutgartit-Shtator 2012

08. Fakte për Lëvizjen e Jusuf Gërvallës-Tetor 2012
09. Luga dhe Lugina-Dhjetor 2012
10. Filharmonia e Jusuf Gërvallës-Janar 2013
11. Shokët dhe Jusuf Gërvalla-Shkurt 2013
12. Fjalori i Lëvizjes së Jusuf Gërvallës-Maj 2013
13. Argatët agresiv-Maj 2013
14. Pa trazime-Qershor 2013
15. Skena-Qershor 2013
16. Emër që u bë traditë-Qershor 2013
17. Jusuf Gërvalla dhe Liria-Korrik 2013
18. Testamenti-Gusht 2013
19. Ilustrime-Janar 2014
20. Vepra e Jusuf Gërvallës-Janar 2014
21. Ti ia ke besuar arkivin e Jusufit-Korrik 2019
22. Qendra Jusuf Gërvalla-Janar 2023
23. Lufta për liri në letrat e Jusuf Gërvallës, Mars 2024
24. Dëshmi e Dëshmorë, Janar 2025
25. HAPËSIRA, KOHA dhe Drita e Jusuf Gërvallës, Shkurt 2025
26. Referenca – Burime I-1979-1983
27. Referenca – Burime II-1982-1985

Jusuf Gërvalla: *“Kështu e pata kuptuar më në fund edhe zgjedhjen e Shpendit (Skenderit-shën im) dhe timen në Komitetin Qendror.”* (14 janar 1981)

Shënime për autorin

Xhafer Durmishi-Skenderi ka lindur në maj 1958 në fshatin Stanoc të poshtëm të komunës së Vushtrisë. Nga arsimtarët e vetë të shkollës fillore angazhohet në organizatën “Lëvizja Nacionalçlirimtare e Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare në Jugosllavi”. Në vitet 1977-1981 ka studiuar në Fakultetin Xehtar-Metalurgjik në Mitrovicë, në degën e Teknologjisë. Nga korriku 1981 gjendet pranë Vëllezërve Gërvalla në Shtutgart. Pas atentatit të 17 Janarit 1982, në mars 1982, falë dhuntive të natyrës, diturive dhe cilësive të ndërgjegjes e tij, me kërkesën e rrethit të Jusuf Gërvallës vazhdon redaktimin e asaj gazete që më parë e kishte redaktuar Jusuf Gërvalla. Fillimisht në redaktimin e plotë dhe në përgatitjen teknike të gazetës kryesore të Lëvizjes për Republikë punon gjer në mars 1983. Pas një qëndrimi prej 100 ditësh në Paris, në korrik 1984 vendoset në Suedi. Në korrik 1985 shërbimet e tij për çështjen apo në emër të çështjes shqiptare, nga rrethi që i kishte qëndruar afër, nuk konsiderohen të nevojshme dhe lirohet nga detyrimet e obligimet e organizuara politike. Vepra e tij pas vitit 1985 e ka bazën në detyrimet e ndërgjegjes. Është përkthyesi i parë i autorizuar për përkthime në mes suedishtes e shqipes. Merret me përkthime. Është njohës i mbi njëzet e pesë gjuhëve të huaja.

XHAFAER DURMISHI-SKENDERI

Dhjetor 2012-Shkurt 2026